



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i
Shkencave në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”
“Universiteti “Luarasi””**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.As. Ana Ktona

Dr. Miranda Harizaj

Korrik /2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Për Programin e studimit Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni"**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Luarasi"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit (Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 418 datë 16.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Urdhëri i regjistrimit të Formës së diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit pararendës:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli II
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Programi nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera
13.1	• Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13.2	• Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
15	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2020-2021: 73 % PAE /27 % PAK
16	Numri i studentëve (për dy vite):	35 Studentë
17	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Luarasi" ka filluar aktivitetin akademik në vitin 2003, pas liçensimit të tij me VKM Nr. 611, datë 11. 09. 2003. Me Urdhër Nr. 71, datë 18. 02. 2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës është realizuar akreditimi i parë për institucionin.


Institucioni ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me agjencinë Britanike të sigurimit të cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 115, datë 15. 12. 2017 që e akrediton institucionin për 6 vite akademike.

Me urdhrin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 266, datë 14. 05. 2018, hapet njësia e tretë në institucion "Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit" pjesë e të cilit është edhe programi Master i Shkencave "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni" i hapur me urdhrin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 418, datë 16. 07. 2018.

Aktualisht programi ka hyrë në procesin e akreditimit. Kohëzgjatja e tij normale është 2 vite dhe numri krediteve të tij është 120 ECTS.

Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë me Urdhër të Ministrit Nr. 493, datë 11. 10. 2019 ka miratuar Statutin e Universitetit Luarasi dhe ka shfuqizuar Statutin e Kolegjit Universitar Luarasi. Me Urdhër të Ministrit Nr. 494, datë 11. 10. 2019 është riorganizuar Kolegji Universitar Luarasi në Universiteti Luarasi.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) është hartuar në vijim të detyrimeve për akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni", ofruar nga Universiteti "Luarasi". Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit, Raportit të vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këtë program studimi, në konstatimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitave në Institucion, si dhe në dokumentacionin shtesë në kuadër të tyre.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Ky raport është përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të jashtëm (GVJ) të përcaktuar me Urdhrin e ASCAL Nr.29, Datë 21. 04. 2021 “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programit të studimit, aplikuar nga Universiteti ‘Luarasi’” dhe në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij ku janë përcaktuar kodi i cilësisë dhe standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të ciklit të dytë të studimeve.

GVJ fillimisht vlerësoi dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga Universiteti Luarasi, në kuadër të procedurës së aplikimit për akreditim të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, e përbërë nga 123 dokumenta në total.

GVJ sipas një agjende të hartuar në funksion të procesit të vlerësimit të programit të studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, kanë realizuar vizitat në datën 7 Maj 2021, në Institucionin e Arsimit të Lartë “Universiteti LUARASI”, sipas veprimtarive të parashikuara në agjendë, në funksion dhe plotësim të procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët.

GVJ ka vijuar punën për hartimin e një raporti të integruar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, bazuar në gjetjet dhe konstatimet e zbatimit të kriterëve të standarteve shtetërore të cilësisë nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti LUARASI”.

Koordinatori teknik i ASCAL në këtë procedurë është ME. Renata Qatipi.

Më datë 22.07.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 32/8 Prot., datë 22.07.2021 “Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, “Universiteti LUARASI” është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

“Universiteti LUARASI” përcjell përgjigjen për Draft-Raportin përmes sistemit AMS dhe zyrtarisht me shkresë Nr.773.Prot., datë 23.07.2021 “Komente në lidhje me Draft-RVJ të programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”. Në këtë dokument institucioni ka komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm.

GVJ, pasi u njoh me komentet, sqaron si më poshtë:

GVJ në FUSHA II – Standardi II.3 - Kriteri 6. - Fq.19: GVJ sugjeron paraqitjen në dy kategori të ndara të veprimtarive mësimore ‘seminar’ dhe ‘laborator’ në syllabuset dhe planin mësimor të programit për të pasur më të lehtë transferimin e studimeve.

Përgjigje e IAL: Veprimtaria mësimore laborator përfshihet në një kategori të vetme me veprimtarinë seminar duke qenë se të gjitha seminarët zhvillohen në laboratorë. Po shqyrtohet mundësia për ti ndare si kategori për ti ardhur në ndihmë studentëve në transferimin e studimeve.

GVJ: Bazuar në vizitën e realizuar në institucion dhe në informacioni e marrë në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se pothuajse të gjitha seminarët dhe leksionet zhvillohen në laboratore ku mundësohet dhe praktikimi i njohurive në kompjuter dhe e ka evidentuar këtë në raport. Kjo duhet përcaktuar në plan programin e studimit dhe syllabuset përkatëse të lëndëve.

Komenti nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA IV – Standardi IV.3 - Kriteri 3. - Fq.46: GVJ rekomandon se softuerët e përdorur në laboratorë, të cilët nuk janë të mjaftueshëm për mbështetjen e pjesës laboratorike të këtij program studimi, në përputhje me kërkesat e lëndëve përkatëse, duhet të përditësohen në përputhje me azhornimin e tyre.

Përgjigje: Softueret e përdorur në laboratorë janë përditësuar sipas listës si vijon:

- eclipse-cpp-2018-09-win32-x86_64
- VirtualBox-6.0.14-133895-Win
- VSCodeUserSetup-x64-1.40.0
- xampp-win32-7.2.11-0-VC15-installer
- npp.7.5.9.Installer.x64
- kali-linux-2019.3-amd64
- ubuntu-16.04.6-desktop-amd64

Të gjitha këto programe i vijnë në ndihmë programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në ‘Teknologji Informacioni dhe Inovacioni’.

GVJ: Bazuar në informacionin shtesë të sjellë nga UL, GVJ konstaton se software-t që disponohen janë të mjaftueshëm për mbështetjen e pjesës laboratorike sipas nevojave dhe kërkesave aktuale për këtë program studimi.

Komenti merret parasysht dhe RVJ ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA IV – Standardi IV.4 - Kriteri 2. - Fq.48 Master i Shkencave në ‘Teknologji Informacioni dhe Inovacioni’: GVJ rekomandon se është e nevojshme që në vazhdimësi të pasurohet literatura fizike për lëndët e programit të studimit në përputhje me programet e azhornuara të lëndëve.

Përgjigje: Institucioni e vlerëson rekomandimin e GVJ. Pavarësisht se Programi i Studimit ka të bëjë me një fushë që zhvillohet me hapa shumë të shpejtë, ku literatura fizike dhe ajo në gjuhën shqipe është në mungesë, çdo vit të ri akademik departamenti bën kërkesë për pasurimin e bibliotekës fizike me publikimet më të fundit.

GVJ: Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, konstatimet dhe rekomandimi i GVJ për pasurimin e literaturës fizike për lëndët e programit qëndron dhe mbështeten dhe nga komenti/sqarimi i dhënë nga institucioni.

Komenti nuk merret parasysht dhe RVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA IV – Standardi IV.4 - Kriteri 5. - Fq.49: GVJ rekomandon se IAL duhet të hartojë dhe zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues për programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” sipas nevojave dhe kërkesave për këtë program studimi.

Përgjigje: Siç është specifikuar në raportin e vlerësimit të brendshëm dhe gjatë takimit me GVJ, mbi shtimin e zërave të bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues, institucioni e ka të rregulluar nëpërmjet formularit procedurën që duhet të ndiqet nga departamenti dhe fakulteti.

GVJ: Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, GVJ ka evidentuar në draft-raport procedurën e rregulluar nga UL për këtë qëllim dhe ka rekomanduar në zbatim të kësaj procedure të vijohet me hartimin dhe zbatimin e planit të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues për programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” sipas nevojave dhe kërkesave për këtë program studimi.

Komenti nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA IV – Standardi IV.5 - Kriteri 1. - Fq.50: GVJ sugjeron marrjen e masave të nevojshme për zhvillimin dhe vënien në funksion të sistemit të brendshëm të sekretarisë mësimore për menaxhimin e plotë të aktivitetit mësimor të studentëve nga regjistrimi deri në përfundim të ciklit të studimeve dhe për këtë program studimi.

GVJ në FUSHA IV – Standardi IV.5 - Kriteri 5. - Fq.52: GVJ sugjeron marrjen e masave të nevojshme për zhvillimin dhe vënien në funksion të sistemit të brendshëm të sekretarisë mësimore për menaxhimin e plotë të aktivitetit mësimor të studentëve nga regjistrimi deri në përfundim të ciklit të studimeve dhe për këtë program studimi, kjo dhe për të garantuar monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe që mundëson raportime individuale dhe të dhëna të konsoliduara dhe në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.

GVJ në FUSHA V – Standardi V.3 - Kriteri 6. - Fq.59 Master i Shkencave në ‘Teknologji Informacioni dhe Inovacioni’: GVJ rekomandon zhvillimin dhe vënien në punë të sistemit të menaxhimit të sekretarisë mësimore për menaxhimin e plotë të informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit mësimor të studentëve.

Përgjigje: Përsa i përket tre rekomandimeve të mësipërme, jemi dakord dhe po punojmë për vënien e plotë në funksion të sistemit të brendshëm të sekretarisë mësimore.

GVJ: Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë dhe mbështeten dhe nga komenti i dhënë nga institucioni.


Komenti nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA IV – Standardi IV.6 - Kriteri 5 - Fq.54: GVJ rekomandon që IAL të angazhohet për gjetjen e burimeve të tjera për financimin e programit të studimit.

Përgjigje: Institucioni është në tentativa të vazhdueshme për të siguruar të ardhura nga burime të tjera, si: marrëveshje me bizneset për programe specifike studimi apo aplikime në projekte financimi mbi programet e studimit.

Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, konstatimet dhe rekomandimi i lënë nga GVJ qëndron dhe mbështetet dhe nga komenti/sqarimi i dhënë nga institucioni.

Komenti nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon vlerësimin.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Teknologji Informatike dhe Inovacioni”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Universiteti Luarasi, rregullores së programit GJV vlerëson se programi i studimit të Ciklit të Dytë Msc në “Teknologji Informatike dhe Inovacioni” nuk bie ndesh me interesat kombëtare. [Evidenca 7 Rregullore Programi, Neni 3: Objektivat Formues të programit]
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nga shqyrtimi i statutit të Universitetit Luarasi dhe Planit Strategjik të tij GJV vlerëson se programet e studimit, përfshirë programin Master i Shkencave “Teknologji Informatike dhe Inovacioni”, synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Ndër të tjera Universiteti Luarasi synon t’u japë studentëve një edukim cilësor të qëndrueshëm, t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim, përdorimit të arritjeve më të mira të dijes dhe të shkencës si dhe partneriteteve me tregun e punës dhe atyre ndërkombëtare. [Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi, neni 3] [Evidenca 8 Plani Strategjik, Misioni] [Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi, neni 3] [Evidenca 8 Plani Strategjik, Misioni]
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GJV konstaton se programi studimit Msc “Teknologji Informatike dhe Inovacioni” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit, në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në fushën e Teknologjisë së Informatikës dhe Inovacionit. [Evidenca 8 Plani Strategjik, Misioni] [Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi, Neni7, Pika 3]
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Gjatë studimit të dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni GJV konstaton se programi i Ciklit të Dytë të studimit Msc në “Teknologji Informatike dhe Inovacioni” është hapur pas studimit të tregut. Nga linku [https://luarasi-univ.edu.al/fakulteti-i-teknologjise-se-informacionit-dhe-inovacionit-2/] citohet se: <i>Qëllimi i programit të studimit Msc “Teknologji Informatike dhe Inovacioni” është të përgatisë profesionistë me formim të lartë për aplikimin dhe zbatimin e teknologjive inovative.</i> [Evidenca 10 Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit]
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Bazuar në rregulloren e programit, objektivat formues përfshijnë: <i>pajisjen e studenteve me njohuri të avancuara kerkimore shkencore ne fushën e Teknologjise</i>

<p>i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p><i>se Informacionit dhe Inovacionit. Nëpërmjet këtij programi studimi synohet ndër të tjera që studentët, të jenë në gjendje të:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>Të dizenojnë zgjidhje të problematikave në fushën e teknologjisë së informacionit duke shfrytëzuar analiza të aplikuara, bazuar në kërkesat e përdoruesve për sisteme të tilla IT.</i> <i>Të identifikojnë, vleresojnë dhe zbatojnë teknologjitë aktuale duke marrë parasysh zbatueshmërinë e tyre ndaj nevojave individuale dhe organizative.</i> <p>Nga [Evidenca 7 Rregullore Programi, Neni 3: Objektivat Formues të programit] citohet: <i>Sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre edhe ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike nëpërmjet vazhdimit të studimeve të ciklit të tretë (doktorata), duke rritur kështu mundësinë e tyre drejt kërkesave për një karriere profesionale-akademike.</i></p> <p>[Evidenca 7 Rregullore Programi, Neni 3: Objektivat Formues të programit]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2 Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit i cili ka si objektiva strategjik, midis të tjerash, cilësinë dhe performancën akademike, kërkimin shkencor dhe inovacionin si dhe reformën kurrikulare në dy drejtime rishikimi i kurrikulave ekzistuese dhe hapja i kurrikulave të reja. Përmbushja e Misionit të Universitetit "Luarasi" (UL) planifikohet të realizohet dhe duke siguruar shumëllojshmëri të ofertave të formimit në përputhje me nevojat e zhvillimit perspektiv të vendit.</p> <p>[Evidenca 8 Plani Strategjik] [Evidenca 8 Plani Strategjik, Misioni]</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Statuti i UL përcakton qartë drejtimit prioritar akademike të tij. Një nga drejtimit prioritar akademike të UL është “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” me të cilin përputhet fusha e studimit të programit të ciklit të dytë Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”</p> <p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit dhe Departamenti Teknologjisë Së Informacionit dhe Inovacionit, që kanë në përgjegjësi realizimin e programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, koordinojnë me efikasitet progresin e tyre me Planin Strategjik të Institucionit dhe me rregulloret specifike të tyre.</p>

	[Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi, Neni 7, Pika 1, 2, 3] [Evidenca 8 Plani Strategjik] [Evidenca 6 Rregullore Fakulteti] [Evidenca 7 Rregullore Programi].			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të institucionit.	GVJ konstaton se programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, emërtohet, organizohet, strukturohet dhe ka përmbajtje në përputhje me fushën akademike Teknologji e Informacionit dhe Inovacionit, e cila është një prej drejtimeve akademike të UL. [Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi, Neni 7, Pika 3] [Evidenca 6 Rregullore Fakulteti] [Evidenca 7 Rregullore Programi].			
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	Kontributi në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal është pjesë e misionit të UL. Programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, është në përputhje me trendet globale pasi fusha e Teknologjisë së Informacionit, është një nga trendet globale të momentit. Thellimi i njohurive në Teknologjinë e Informacionit është gjithashtu në interesin kombëtar të vendit dhe në mbështetje të strategjive kombëtare të zhvillimit. [Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi, neni 3; pika d]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	<p>GVJ konstaton, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB, se në programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” përshkruhen qartë objektivat e mësimdhënies dhe se ky program realizohet në përputhje me këto objektiva.</p> <p>Bazuar në rregulloren e programit, objektivat formues përfshijnë: <i>pajisjen e studenteve me njohuri të avancuara kerkimore shkencore ne fushën e Teknologjise se Informacionit dhe Inovacionit. Nëpërmjet këtij programi studimi synohet ndër të tjera që studentët, të jenë në gjendje të:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>Të dizenojnë zgjidhje të problematikave në fushën e teknologjisë së informacionit duke shfrytëzuar analiza të aplikuara, bazuar në kërkesat e përdoruesve për sisteme të tilla IT.</i> <i>Të identifikojnë, vleresojnë dhe zbatojnë teknologjitë aktuale duke marrë parasysh zbatueshmërinë e tyre ndaj nevojave individuale dhe organizative.</i> <p>Këto objektiva i gjejnë të trupëzuar në kurrikulën që ofrohet, organizimi i planit mësimor, ndarja e moduleve në vite, syllabuset, orët teorike dhe ato praktike, laboratorët dhe praktikat profesionale.</p>

	<p>Nga shqyrtimi dokumentacionit rezulton se programi i Ciklit të Dytë të studimit është hapur në përputhje me kërkesën e tregut për specialist të fushës Teknologji Informacioni dhe ne menaxhimin e Inovacionit të konstatuar nga institucioni në studimin e tregut.</p> <p>[Evidenca 7 Rregullore Programi, Neni 3: Objektivat Formues të programit;] [Evidenca 11 Programi Studimit] [Evidenca 10 Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Institucioni ka realizuar studimin për tregun e punës përpara hapjes së programit. Në këtë studim përfshihen të dhëna nga komunikimi me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve. Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve, të programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, jepen në DVV.</p> <p>Institucioni akoma nuk ka kryer studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron, pas daljes së studentëve, megjithëse është diplomuar brezi i parë i studentëve.</p> <p>Institucioni planifikon gjithashtu vënien në funksion të një panairi virtual pune, të krijuar nga ekipi zhvillues IT - Fakulteti i Teknologjise se Informacionit dhe Inovacionit, me qëllim që studentët e programit të studimit por edhe studentët e diplomuar të kene mundësi të vihen në kontakt për mundësi punësimi me bizneset apo institucionet shtetërore dhe private.</p> <p>[Evidenca 12 Te dhena tabelore per punesimin real te studenteve] [Evidenca 10 Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit] [Evidenca 13 Raport për projektet Luarasi, Pika 6, Panairi i Virtual i Punës]</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathësisë e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat formuese struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p> <p>Studentët që diplomohen në programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” mund të punojnë si: Drejtor IT/Shef Sektori i strukturave të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (ICT); Administrator Bazash të Dhënash; Menaxher i Projekteve të Teknologjisë së Informacionit; Menaxher i Sistemeve të Informacionit.</p> <p>[Evidenca 7 Rregullore Programi] [Evidenca 10 Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit] [Evidenca 11 Programi Studimit]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimit të studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Përpara hapjes së programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, UL ka shqyrtuar programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare të AL.</p> <p>Nga dokumentacioni në DVV GVJ konstaton se pjesë e misionit të UL është të krijojë dhe mbështesë standardet të larta në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimit shkencor, projekteve dhe inovacionit, në përputhje me Standardet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar objektivat e procesit të Bolonjës. Nga kjo përjasje, GVJ mendon se</p>

	procedurat e transferimit të dijeve ose dhe punësimi i ardhshëm i studentëve të këtij programi studimi në tregun ndërkombëtar nuk ka pengesa.
Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.	<p>Programit i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” mbështetet në përvojën 17 vjeçare të institucionit. Programi i studimit është hartuar mbështetur në legjislacionin në Shqipëri.</p> <p>Misioni i Universitetit Luarasi, ndër të tjera përfshin, krijimin dhe mbështetjen e standardeve më të larta në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me Standardet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL)</p> <p>[Evidenca 10 Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit] [Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi, Neni 3: Misioni; Pika b;] [VKM Nr. 611 Datë 11. 09. 2003; Evidenca 1 Urdher Hapje Programi] [Evidenca 5 Statuti Universiteti Luarasi, Neni 3: Misioni, Pika b].</p>
Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	<p>Programi Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit.</p> <p>Praktika profesionale është e përfshirë në programin mësimor të Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” në semestrin e katërt. Ajo ka 12 kredite. Praktikatat profesionale janë realizuar në institucionete mëposhtme: Universiteti Luarasi, Finetuning, LocalWeb, Shkolla “Hermann Gmeiner “Tirane, Protik, Ministria e Brendshme, Warwick shpk, BALFIN, Autopasion Sh.a, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Raiffeisen Bank, Intercall albania , Ujësjetllës Kanalizime Krujë, etj.</p> <p>[Evidenca 7 Rregullore Programi, Kreu 2, Neni 4; Evidenca 11 Programi i studimit; Evidenca 22 Institucionet ku janë kryer praktikatat mesimore] [Evidenca 7 Rregullore Programi, Kreu2, Neni 3: Objektivat Formues të Programit]</p>
	<p>Programi Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” është licencuar në gjuhën shqipe dhe ofrohet në këtë gjuhë. GVJ konstaton se UL ka disa bashkepunime ndërkombëtare në kuadër të ERASMUS dhe sipas GVB krijon mundësinë që për studentët Erasmus, lëndë specifike të ofrohen në gjuhë të huaj sipas kërkesave të ardhura dhe planeve mësimore të Universiteteve partnere.</p> <p>Por deri në fazën e vizitës në UL GVJ konstaton se nuk ka pasur mësimdhënie të ndonjë lënde në gjuhën angleze.</p> <p>[Evidenca 1 Urdher Hapje Programi] [Evidenca 14 Marreveshjet Erasmus tabela] [RVB].</p>
Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	<p>Dokumentacioni dhe aktiviteti i zhvilluar për programin Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, duke qënë se është licencuar në gjuhën shqipe dhe ofrohet në këtë gjuhë, janë të arkivuara vetëm në gjuhën shqipe.</p> <p>[Evidenca 1 Urdher Hapje Programi]</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>GVJ konstaton, nga vlerësimi i dokumentacionit dhe vizitave në institucion, se Universiteti Luarasi ka përvojën (eksperiencë 17 vjeçare në fushën akademike), kapacitetet si në infrastrukturë dhe struktura ndihmëse universitare dhe burimet e duhura në fushën e teknologjisë së informacionit.</p> <p>Personeli Akademik Efektiv (PAE) në njësinë kryesore ku zhvillohet programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, përbëhet nga: 3 Profesorë, 2 Profesorë të Asociuar, 5 Lektorë me gradën Dr dhe 11 Asistent-Lektorë.</p> <p>Personeli akademik në programin e studimit ku janë 14 anëtarë gjithsej, në vitin 2020-2021, të gjithë me grada e tituj (3 Profesorë, 4 Profesorë të Asociuar, 7 Lektore me gradën Dr), është i kualifikuar, me një përvojë shumëvjeçare në këtë fushë studimore dhe aplikative, gjë që mundëson rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.</p> <p>[Evidenca 15 Personeli akademik në Njësinë kryesore dhe Njësinë përgjegjëse] [Evidenca 16 Personeli akademik në programin e studimit] [Evidenca 11 Programi i studimit] [CV Emër Mbiemër].</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Njësia kryesore, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, ofron programe studimi në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit që prej vitit 2018. Drejtimet kërkimore shkencore 2018-2021 të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit janë Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit, Teknologjia e Informacionit dhe Inovacionit.</p> <p>Programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, i ofruar nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit ka si fushë të përgjithshme fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit dhe fushë specifike Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit, Teknologjia e Informacionit dhe Inovacionit.</p> <p>GVJ konstaton se aktiviteti mësimor-kërkimor i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit.</p> <p>[Evidenca 18 Te dhena tabelore për numrin e programeve] [Evidenca 19 Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit] [Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi] [Evidenca 6 Rregullore Fakulteti] [Evidenca 7 Rregullore Programi].</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Ndarja e detyrave mes njësive e personelit përcaktohet nga institucioni në rregulloren tij dhe në rregulloren e njësive kryesore. Nga vlerësimi rezulton se Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit menaxhon dhe drejton me efektivitet programin e ciklit të dytë Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” i cili ka një kohëzgjatje 2-vjeçare dhe në total përmban 120 kredite. Vërehet një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha strukturat e institucionit (Njësia e Brëndshmë të Sigurimit të Cilësisë, Sekretaria mësimore, Arkiva dhe protokolli, Zyra e burimeve njerëzore, Zyra e zhvillimit të kurrikulave, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Zyra e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë etj) dhe departamentet e tjera në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit dhe Universitetin Luarasi që rrit efektivitetin e këtij programi studimi. [Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi, Neni 14-20, 28, 98- 104] [Evidenca 6 Rregullore Fakulteti] [Evidenca 16 Personeli akademik në programin studimit]
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	GVJ konstaton se, Universiteti Luarasi ka bashkëpunime ndër-institucionale me institucione shtetërore dhe IAL brenda vendit, si dhe me kompani dhe zyra, pjesë e komunitetit të biznesit ose tregut të punës. Realizimi i praktikave profesionale mbetet një ndër bashkëpunimet kryesore me këto institucione. Me anë të këtyre bashkëpunimeve UL synon gjithashtu krijimin e lidhjeve midis universitetit dhe aktorëve të tregut të punës në funksion të punësimit të studentëve por edhe për të qënë më pranë nevojave të tregut të punës dhe reflektimit të tyre në programin e studimit. Ndër institucionet bashkëpunuese me Universitetin Luarasi 11 janë institucione qeveritare, 4 janë organizata profesionale dhe 10 janë nga komuniteti i biznesit. [Evidenca 21 Institucionet bashkëpunuese me Luarasin]
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	GVJ konstaton se, Universiteti Luarasi ka nënshkruar marrëveshje të posaçme me institucione, kompani të fushës së Teknologjisë së informacionit dhe Sigurisë së saj, ku pjesë e bashkëpunimit është edhe realizimi i praktikave profesionale të programit të ciklit të dytë Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”. Universiteti Luarasi ka bashkëpunuar me institucione të ndryshme për realizimin e praktikave të këtij programi. [Evidenca 21 Institucionet bashkëpunuese me Luarasin] [Marrëveshje Bashkëpunimi <i>Emri Institucionit</i>] [Evidenca 22 Institucionet ku janë kryer praktikave mesimore]

Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.	GVJ konstaton se, procedura e zhvillimit të praktikave profesionale është e rregulluar nëpërmjet udhëzuesit për zhvillimin e praktikës. Në të janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen ashtu edhe roli i aktorëve dhe njësisë të ndryshme të përfshira në këtë proces. [Evidenca 23 Udhëzues për zhvillimin e praktikës]			
Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	Universiteti Luarasi ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione kërkimore shkencore vendase dhe të huaja. UL është gjithashtu udhëheqës në projektin “Strengthening regional academic and research exchange” të financuar nga “Western Balkans Fund (WBF)”. Në këtë projekt përfshihet shkëmbimi i eksperiencave dhe rezultateve kërkimore shkencore nga katër universitete të rajonit. [Evidenca 21 Institucionet bashkëpunuese me Luarasin] [Evidenca 14 Marrëveshjet Erasmus tabela] [Evidenca 50 Projekti WBF]			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	GVJ konstaton se Universiteti Luarasi ka realizuar një Analizë të Departamentit përgjegjës për programin e studimit. Në të nuk ka raportim analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve. GVJ sugjeron që krahas rritjes së numrit të bashkëpunimeve, UL të kujdeset edhe për hartimin e raporteve analitike të përfitimit nga marrëveshjet. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se puna me projektin “Strengthening regional academic and research exchange” ka sjellë shumë përfitime në funksion të realizimit të programit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” dhe programeve të tjera të studimit në këtë departament. [Evidenca 19 Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit] [Vizita në Institucion: Shenime ne vizite_7 Maj_Luarasi]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.6

Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	GVJ konstaton se, UL ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve. Në dokumentin [Evidenca 20.2 Planifikimi i Kërkimit Shkencor] specifikohen edhe bonuset që jepen për stafin akademik për Publikime Shkencore sipas Llojit të Publikimit. Kjo gjë u theksua edhe në takimet e GVJ me stafin akademik.

	[Evidenca 20 Strategjia e Kerkimit Shkencor] [Evidenca 20.1 Buxheti mbi kerkimin shkencor] [Evidenca 32. 1 Udhezues_Konference Studentore_Luarasi]			
Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kerkimit shkencor.	<p>GVJ konstaton se në strategjinë e kerkimit shkencor të UL përcaktohet shprehimisht se: “Drejtimi strategjik i kerkimit shkencor bëhet nga Zv. Rektori për Kerkimin Shkencor, Projektet dhe Inovacionin në bashkëpunim me Zyrën e Kerkimit Shkencor dhe Studimeve Doktorale, Zyren e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe Senatit Akademik, të cilët monitorojnë dhe vlerësojnë ndërtimin e Strategjise së Kerkimit Shkencor Projekteve dhe Inovacionit (SKSHPI) me një vizion afatmesëm dhe afatgjatë, mbikëqyrin zbatimin e saj dhe përditësojnë prioritetet e kerkimit shkencor në përputhje me synimet e Universitetit Luarasi”.</p> <p>GVJ bëri takim edhe me Zyrën e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, ku konstatoi një punë shumë të mirë të kësaj zyre, si mbështetje për kerkimin shkencor.</p> <p>[Evidenca 20 Strategjia e Kerkimit Shkencor]</p>			
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kerkimit shkencor.	<p>UL çdo vit akademik një pjesë të buxhetit e shfrytëzon për kerkimin shkencor UL harton gjithashtu një dokument të planifikimit për Kerkimin Shkencor të vitit akademik. Politikën e ndryshme që institucioni ndjek në promovimin e rezultateve në fushën e kerkimit shkencor përcaktohen në këtë dokument. Në kuadër të projektit “Strengthening regional academic and research exchange” UL ka organizuar konferencën ndërkombëtare “Contemporary Trends and Multidisciplinary Issues in Nowadays Society” ku janë prezantuar rezultatet në fushën e kerkimit shkencor të stafit akademik.</p> <p>[Evidenca 20.1 Buxheti mbi kerkimin shkencor] [Evidenca 20.2 Planifikimi i Kerkimit Shkencor] [Evidenca 32 Conference Proceedings 2020]</p>			
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kerkimore-botuese.	<p>GVJ konstaton se në dokumentin [dok DVV Evidenca 20 Strategjia e Kerkimit Shkencor] UL ka një udhëzues mbi praktikën e mirë kerkimore botuese nën seksionin ‘Rregulla etike për kerkimin shkencor’.</p>			
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kerkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kerkimit shkencor	<p>Në dokumentin mbi planifikimin e kerkimit shkencor, është e specifikuar se në projektet kerkimore në grup të financuar nga UL inkurajohet dhe angazhimi i studentëve të nivelit Bachelor/Master. Gjithashtu inkurajohet publikimi në revista shkencore me faktor impakti duke i caktuar dhe një bonus në vlera monetare.</p> <p>[Evidenca 20.2 Planifikimi i Kerkimit Shkencor]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>GVJ konstaton se programi i ciklit të dytë Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Ky program studimi ka një kohëzgjatje normale 2 vite dhe në total 120 kredite.</p> <p>Detyrimi përmbyllës për marrjen e diplomës shlyhet në trajtën e mbrojtjes së diplomës me temë.</p> <p>[VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018; VKM Nr.879, date 18.12.2019] [Evidenca 7 Rregullore Programi; Evidenca 11 Programi Studimit]</p>
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	<p>GVJ konstaton se programi i ciklit të dytë Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, nëpërmjet moduleve dhe lëndëve të ofruara krijon mundësinë e formimin e shprehive të veçanta. Studimi i Tregut evidentoi disa specialitete për të cilat formohen studentët e këtij programi. Disa nga profesionet dhe specialitetet për të cilat formohen studentët e Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” janë: Ekspert dhe drejtues në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit; Drejtor IT në institucione publike dhe private; Menaxher projektsh; Menaxher i sistemeve të informacionit; Kërkues shkencor në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit.</p> <p>[Evidenca 7 Rregullore Programi; Evidenca 11 Programi Studimit] [Syllabuse 2020-2021] [Evidenca 10 Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit]</p>
Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe intervistave gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se programi i Ciklit të Dytë të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, thellon njohuritë e studentëve në fushën e Teknologjisë së Informacionit, ku një vend të konsiderueshëm në program zë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës së menaxhimit të Sistemeve të Informacionit dhe Sigurisë së Informacionit.</p> <p>[Evidenca 7 Rregullore Programi, Neni 3: Objektivat Formues të programit] [Evidenca 11 Programi Studimit; Syllabuse 2020-2021]</p>
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të	<p>Ndër objektivat formuese të programit të Ciklit të Dytë të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, është t’u japë studentëve njohuritë me imperative dhe më bashkëkohore të nevojshme në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, mbështetur në këndvështrimin kërkimor-shkencor. Ndër të tjera programi synon që studentët të jenë në gjendje të dizenojnë zgjidhje të problematikave në fushën e teknologjisë së informacionit duke shfrytëzuar analiza të aplikuara, bazuar në kërkesat e përdoruesve për sisteme të tilla IT.</p>



paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	GVJ konstaton se objektivat formuese përmbushen mjaft mirë dhe kjo rezulton e shprehur qartë në [Evidenca 11 Programi Studimit; Syllabuse 2020-2021]. [Evidenca 7 Rregullore Programi, Neni 3: Objektivat Formues të programit]
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	GVJ konstaton se programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” përmban të shprehura në mënyrë eksplicite shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj., të cilat rezultojnë të paraqitura në përputhje me akte ligjore e nënligjore Për të gjitha lëndët/modulet janë dhënë ngarkesa në kredite, format e ndryshme të mësimdhënies, orët mësimore në auditor dhe ngarkesa jashtë auditorit, kategoria të cilës i përket, etj. [Evidenca 7 Rregullore Programi; Evidenca 11 Programi Studimit;]
Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Nga shqyrtimi i programit mësimor dhe syllabuseve rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh. GVJ konstaton se lëndët/modulet janë grupuar sipas veprimtarive formuese në përputhje me VKM 41, më poshtë: A. LËNDË BAZË B. LËNDË KARAKTERIZUESE C. LËNDË NDËRDISIPLINORE D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika) E. DETYRIME PËRMBYLLËSE Programi ka të përcaktuara veprimtaritë formuese, kryesisht leksione dhe seminare. Gjatë vizitës GVJ konstatoi se pothuajse të gjitha seminarët dhe leksionet zhvillohen në laboratore ku mundësohet dhe praktikimi i njohurive në kompjuter. <i>GVJ sugjeron shtimin e orëve laboratorike në veprimtaritë formuese të programit të studimit.</i> [Evidenca 7 Rregullore Programi; Evidenca 11 Programi Studimit] [Syllabus 2020 2021] [Vizita në Institucion: Shenime ne vizite_7 Maj_Luarasi]
Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	Nga shqyrtimi i programit mësimor GVJ konstaton se punimi i diplomes në programin Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” ka 18 kredite. UL ka hartuar rregulloren e diplomimit dhe udhëzuesin e shkrimit të diplomës. Aktivitet në kuadër të diplomës përfshijnë takime me pedagogun, përgatitjen dhe monitorimin e procesit të hartimit dhe shkruarjes së diplomës sipas manualit dhe kërkesave për shkrimin e diplomës. [Evidenca 7 Rregullore Programi] [Evidenca 11 Programi Studimit] [Evidenca 26 Rregullore e diplomimit] [Evidenca 26.1 Udhëzuesi i shkrimit të diplomes]

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																											
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Institucioni ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 115, datë 15. 12. 2017 që e akrediton institucionin për 6 vite akademike.</p> <p>Institucioni ka bërë riorganizimin dhe kalimin nga Kolegj Universitar në Universitet dhe në këtë kuadër i është nënshtruar një procesi riakreditimi të pjesshëm. Me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 52, datë 27. 11. 2020 ka rimarrë akreditim pozitiv me afat deri në 14.12 2023.</p> <p>Programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” është hapur me urdhrin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 418, datë 16. 07. 2018. Programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” i nënshtrohet për herë të parë procesit të akreditimit</p> <p>[Evidenca 48 Certifikata e Akreditimit] [Evidenca 2 Urdher Per hapjen e Fakultetit]</p>																											
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënlige për organizimin dhe strukturën akademike.	<p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit ofron programe studimi që prej vitit 2018. Ky fakultet është licencuar me Urdhër Nr. 266, datë 14.05.2018. Ai përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Në këtë fakultet janë tre njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Departamenti i Informatikës Ekonomike,2. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit dhe3. Departamenti i Matematikës dhe Statistikës. <p>Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, ku zhvillohet programi i studimit MSc ka 7 anëtarë të brendshëm ku 3 prej tyre janë me grada dhe tituj përkatësisht 2 me titullin Profesor të Asociuar dhe 1 me gradën Doktor.</p> <p>[Evidenca 2 Urdher Hapje Programi] [Tabelat permbljedhese]</p>																											
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	<p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit përbëhet nga 21 anëtarë të personelit akademik të brendshëm dhe 26 anëtarë të personelit akademik me kontratë kësaj shpërndarjeje:</p> <table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th><th colspan="2">Departamenti i Informatikës Ekonomike</th><th colspan="2">Departamenti i Matematikës dhe Statistikës</th><th colspan="2">Departamenti Teknologjise së Informacionit dhe Inovacionit</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>1</td><td>1</td><td>2</td><td>1</td><td></td><td>1</td></tr><tr><td>Prof.Assoc</td><td></td><td></td><td></td><td>3</td><td>2</td><td>3</td></tr></table>	Kualifikimi i stafit	Departamenti i Informatikës Ekonomike		Departamenti i Matematikës dhe Statistikës		Departamenti Teknologjise së Informacionit dhe Inovacionit		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	1	1	2	1		1	Prof.Assoc				3	2	3
Kualifikimi i stafit	Departamenti i Informatikës Ekonomike		Departamenti i Matematikës dhe Statistikës		Departamenti Teknologjise së Informacionit dhe Inovacionit																							
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																						
Prof.Dr	1	1	2	1		1																						
Prof.Assoc				3	2	3																						

	<table><tr><td>Dr/PhD</td><td>2</td><td>3</td><td>2</td><td>4</td><td>1</td><td>3</td></tr><tr><td>Msc</td><td>4</td><td>1</td><td>3</td><td>2</td><td>4</td><td>4</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>7</td><td>5</td><td>7</td><td>10</td><td>7</td><td>11</td></tr></table> <p>GVJ konstaton se Dekani i Njesisë kryesore, është ngarkuar njëkohësisht edhe si përgjegjës i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit.</p> <p>Për sa më sipër GVJ konstaton se Njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p>[Evidenca 17 Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik] [Evidenca 15 Personeli akademik në Njësinë kryesore dhe Njësinë përgjegjëse]</p>	Dr/PhD	2	3	2	4	1	3	Msc	4	1	3	2	4	4	Gjithsej	7	5	7	10	7	11
Dr/PhD	2	3	2	4	1	3																
Msc	4	1	3	2	4	4																
Gjithsej	7	5	7	10	7	11																
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion të programit tre laboratorë. Çdo pedagog është përgjegjës për realizimin e praktikave laboratorike të lëndës përkatëse. Për realizimin e praktikave mësimore caktohet personi përgjegjës në programin e studimit si dhe personi në insitucionin/kompaninë ku zhvillohet praktika.</p> <p>[Vizita në Institucion: Shenime ne vizite_7 Maj_Luarasi] [Evidenca 23: Udhëzues per zhvillimin e praktikës/ pika 4: Strukturat përgjegjëse për ndjekjen e praktikës]</p>																					
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<p>Përgjegjësia për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij është e përgjegjësit të departamentit.</p> <p>Përgjegjësia për ecurinë e praktikave profesionale përcaktohet në Udhëzuesin për zhvillimin e praktikës/ pika 4: Strukturat përgjegjëse për ndjekjen e praktikës.</p> <p>[Evidenca 6 Rregullore Fakulteti neni 7, pika c] [Evidenca 23 Udhëzues per zhvillimin e praktikës/ pika 4]</p>																					
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njesisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	<p>Drejtuesi i departamentit është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij.</p> <p>[Evidenca 6 Rregullore Fakulteti neni 7/pikac]</p>																					
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table><tr><td></td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr></table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X													
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht																			
			X																			

Standardi II.3

Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë,	GVJ konstaton se Departamenti Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për

disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: Rregulloren programin mësimor, syllabuset, orarin, Ngarkesën e stafit akademik etj. Dosja e plotë e cdo viti mbahet në departamentin përkatës. [Evidenca 16 Personeli akademik në programin studimit]; [Evidenca 17 Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik] [Evidenca 7 Rregullore Programi] [Evidenca 11 Programi studimit] [Syllabus 2020 - 2021] [Evidenca 46 Orari]																										
Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	GVJ konstaton se veprimtaritë formuese janë shpërndarë në përputhje me VKM 41. Veprimtaritë formuese kanë një shpërndarje si në tabelën më poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Kategoria /</th><th rowspan="2">Përqindja Krediteve Sipas VKM</th><th colspan="2">Programi TII</th></tr><tr><th>Kredite</th><th>Përqindje</th></tr><tr><td>A. LËNDË BAZË</td><td>5%-10%</td><td>12</td><td>10%</td></tr><tr><td>B. LËNDË KARAKTERIZUESE</td><td>50%- 60%</td><td>60</td><td>50%</td></tr><tr><td>C. LËNDË NDËRDISIPLINORE</td><td>12%-20%</td><td>18</td><td>15%</td></tr><tr><td>D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)</td><td>10%</td><td>12</td><td>10%</td></tr><tr><td>E. DETYRIME PËRMBYLLËSE</td><td>10%- 15%</td><td>18</td><td>15%</td></tr></table> Nga shqyrtimi i rregullores së programit, planit mësimor dhe syllabuseve, GVJ konstaton se programi përmban: 15 lëndë + Praktika profesionale + Punimi i Diplomës. Në syllabsuet e lëndëve paraqitet qartë ndarja e elementëve të lëndës (leksion, seminar). Rezulton se elementët e veprimtarisë mësimore ‘seminar’ dhe ‘laborator’ përfshihen në një kategori të vetme. [Evidenca 7 Rregullore Programi] [Evidenca 11 Programi Studimit] [Vizita në Institucion: Shenime ne vizite_7 Maj_Luarasi]	Kategoria /	Përqindja Krediteve Sipas VKM	Programi TII		Kredite	Përqindje	A. LËNDË BAZË	5%-10%	12	10%	B. LËNDË KARAKTERIZUESE	50%- 60%	60	50%	C. LËNDË NDËRDISIPLINORE	12%-20%	18	15%	D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)	10%	12	10%	E. DETYRIME PËRMBYLLËSE	10%- 15%	18	15%
Kategoria /	Përqindja Krediteve Sipas VKM			Programi TII																							
		Kredite	Përqindje																								
A. LËNDË BAZË	5%-10%	12	10%																								
B. LËNDË KARAKTERIZUESE	50%- 60%	60	50%																								
C. LËNDË NDËRDISIPLINORE	12%-20%	18	15%																								
D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)	10%	12	10%																								
E. DETYRIME PËRMBYLLËSE	10%- 15%	18	15%																								
Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton e shprehur qartë shpërndarja e krediteve në katër semestra dhe për secilën lëndë apo veprimtari brenda programit. Programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” rezulton me 30 kredite për semestër, 60 kredite në një vit të plotë akademik dhe dy vite akademike. [Evidenca 11 Programi Studimit]																										
Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	GVJ konstaton se plani mësimor përmban informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Frekuentimi ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e programit dhe syllabuset. Në syllabuset e lëndëve, jepet informacion në lidhje me temat mësimore në leksione dhe në seminarëve, orët faktike për secilën prej temave, detyrimet lidhur me lëndën, etj. Frekuentimi / ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi i dijeve gjatë vitit bëhet si më poshtë:																										

	<ul style="list-style-type: none">- 10% niveli i diskutimit në seminare- 20% detyrë kursi- 30% provimi i ndërmjetëm- 40% provimi përfundimtar <p>Për frekuentimin e studentëve IAL ka vendosur se prezenca në veprimtaritë mësimore në auditor është e detyrueshme në masën 80%:</p> <p>[Evidenca 11 Programi Studimit] [Evidenca 7 Rregullore Programi] [Syllabus 2020-2021]</p>			
Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Rregullorja e programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” përmban të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>[Evidenca 7 Rregullore Programi, Neni 5, 9].</p>			
Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se syllabuset e lëndëve janë të paraqitura në strukturë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi.</p> <p>Elementët e veprimtarisë mësimore ‘seminar’ dhe ‘laborator’ përfshihen në një kategori të vetme. <i>GVJ sugjeron paraqitjen në dy kategori të ndara të veprimtarive mësimore ‘seminar’ dhe ‘laborator’ në syllabuset dhe planin mësimor të programit për të pasur më të lehtë transferimin e studimeve.</i></p> <p>[Syllabus 2018-2019; Syllabus 2019-2020] [Syllabus 2020-2021] [VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018; VKM Nr.879, date 18.12.2019]</p>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht	<p>GVJ konstaton se stafit akademik i kërkohet të përditësojë syllabuset në fillim të vitit akademik. Sipas RVB, programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme.</p> <p>[Syllabus 2018-2019] [Syllabus 2019-2020] [Syllabus 2020-2021]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/ “Master i Arteve” është	GJV konstaton se programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” është i organizuar në 2 vite akademike, me 120 kredite në total.

strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Konstatohet se ky organizim është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ndarja e orëve mësimore është si më poshtë:</p> <table><tr><th rowspan="2">Viti akademik</th><th colspan="3">Mesim ne auditor dhe terren</th><th rowspan="2">Total ore / (120 ECTS)</th></tr><tr><th>Auditor</th><th>Studim individual</th><th>Praktika profesionale</th></tr><tr><td>Viti I</td><td>600</td><td>900</td><td>-</td><td>1500</td></tr><tr><td>Viti II</td><td>575</td><td>700</td><td>225</td><td>1500</td></tr><tr><td>Total</td><td>1175</td><td>1600</td><td>225</td><td>3000</td></tr></table> <p>[Evidenca 11 Programi Studimit]</p>	Viti akademik	Mesim ne auditor dhe terren			Total ore / (120 ECTS)	Auditor	Studim individual	Praktika profesionale	Viti I	600	900	-	1500	Viti II	575	700	225	1500	Total	1175	1600	225	3000
Viti akademik	Mesim ne auditor dhe terren			Total ore / (120 ECTS)																				
	Auditor	Studim individual	Praktika profesionale																					
Viti I	600	900	-	1500																				
Viti II	575	700	225	1500																				
Total	1175	1600	225	3000																				
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se emërtimi i programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” është në përputhje me fushën akademike të tij. Përmbajtja e veprimtarive mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike.</p> <p>Nga dokumenti [Evidenca 7 Rregullore Programi, Neni 3: Objektivat Formues të programit] GVJ citon: <i>Sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre edhe ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike nëpërmjet vazhdimet të studimeve të ciklit të tretë (doktorata), duke rritur kështu mundësinë e tyre drejt kërkesave për një karriere profesionale-akademike.</i></p> <p>Në lidhje me sa më lart, GVJ vlerëson se ky program studimi mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike, një element mjaft i rëndësishëm ky për t’u përballur me tregun e punës pas diplomimit të tyre apo thellimit të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme.</p>																							
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se mundësohet arritja e objektivave formues të programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” dhe rezultateve të pritshme të të nxënit, aftësimi profesional dhe kërkimit shkencor.</p> <p>[Evidenca 7 Rregullore Programi; Evidenca 11 Programi Studimit; Syllabus 2020-2021] [Vizita në Institucion: Shenime ne vizite_7 Maj_Luarasi]</p>																							
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se lëndët janë në përputhje me profilin e programit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” dhe, rrjedhimisht, të domosdoshme për formimin e specialistëve në këtë fushë studimi. Nga vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit master.</p> <p>Lëndët janë të organizuara në aktivitete formuese Leksion/Ushtime (seminar).</p> <p>Në secilën prej tyre ka aktivitete formuese teorike dhe praktike Në këtë kurrikul shpërndarja e krediteve në aktivitetet formuese është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none">Leksione 45 ECTS																							



	<ul style="list-style-type: none"> • Seminare /Laboratorë / 45 ECTS • Detyra/Projekte/diplomë 18 ECTS • Praktikë 12 ECTS <p>Nëse do t'i referoheshim orëve të planifikuar në auditor për këto aktivitete formuese rezulton si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksione 450 Orë në auditor • Seminare /Laboratorë 450 Orë në auditor • Detyra/Projekte/diplomë 200 Orë në auditor • Praktikë 75 Orë në auditor <p>Raporti teori me praktike është 38% me 62%. GVJ gjykon që ky raport është në përputhje me profilin e programit master.</p> <p>[Evidenca 11 Programi Studimit; Syllabus 2020-2021] [Vizita në Institucion: Shenime ne vizite_7 Maj_Luarasi]</p>
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>Gjatë intervistave me personelin akademik dhe me studentët evidentohet se raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe formimin e specialistëve të aftë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit.</p> <p>Pra, orët në auditor për përgatitjen praktike (Seminare, laboratorë, projekte praktikë, etj) janë më të larta se për përgatitjen teorike (orët e leksioneve). GVJ gjykon që raporti i tyre është në përputhje me ciklin e dytë të studimeve.</p> <p>[Shenime ne vizite_7 Maj_Luarasi] [Evidenca 7 Rregullore Programi, Neni 3: Objektivat Formues të programit]</p>
Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	<p>Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion GVJ konstaton se syllabuset rishikohen në fillim të vitit akademik për të futur literaturat e reja, të cilat duhet të jenë të 5 viteve të fundit, ose paper-at e reja të vetë pedagogëve. Disa nga literaturat në syllabuse nuk janë të 5 viteve të fundit. Hapat tepër të shpejtë të zhvillimit të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit e bëjnë shumë të vështirë krijimin e literaturave përkatëse.</p> <p>[Syllabus 2018-2019; Syllabus 2019-2020; Syllabus 2020-2021]</p>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.	<p>GVJ konstaton, bazuar në lëndët e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përkatëse, se programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi dhe niveli master. Disa nga lëndët që përfshihen në këtë program dhe që garantojnë përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi (Ekspert dhe drejtues në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit; Menaxher projektsh; Menaxher i sistemeve të informacionit; Kërkues shkencor në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit) janë: Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; Hartim Dhe Menaxhim Projektsh Në Teknologji Informacioni; Menaxhim</p>

	strategjik i teknologjisë dhe Inovacionit; Metoda Kërkimi të Avancuara në Teknologji Informacioni. etj [Evidenca 11 Programi Studimit; Syllabus 2020-2021]			
Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” u jep mundësi studentëve të pozicionohen qartësisht në karrierën e tyre të ardhshme profesionale. Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se, programi i studimit duke kombinuar teorinë me praktikën siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional në fushën e teknologjisë së informacionit. [Evidenca 11 Programi Studimit; Syllabus 2020-2021]			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Përpara hapjes së programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, Universiteti Luarasi kreu një analizë të tregut të punës e cila u përdor për krijimin e përmbajtjes së programit të studimit. Përmbajtja e programit të studimit synon të mundësojë punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Në dokumentin e dorëzuar nga institucioni për punësimin real të studentëve jepen të dhëna për 13 studentë të punësuar nga brezi i parë i studentëve të diplomuar në Shtator 2020. [Evidenca 10 Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit] [Evidenca 11 Programi Studimit] [Syllabus 2020-2021][Evidenca 12 Te dhena tabelore per punesimin real te studenteve]			
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	GVJ konstaton se njohuritë e fituara gjatë programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” i pajisin studentët me formimin e nevojshëm për të ndjekur studimet e ciklit të tretë. Studentët inkurajohen nga institucioni duke i udhëzuar ata për marrjen pjesë në konferenca (institucioni ka dorëzuar evidencën 32.1 me këtë udhëzim) dhe u jepet mundësia të marrin pjesë në konferencat shkencore vjetore të organizuara nga UL, nëpërmjet të cilave kanë mundësi të realizojnë dhe prezantojnë veprimtari kerkimore dhe të diskutojnë mbi të rejtat më të fundit në fushën e tekonologjisë së informacionit. [Evidenca 32 Conference Proceedings 2020; Evidenca 32. 1 Udhëzues_Konference Studentore_Luarasi]. [Evidenca 11 Programi Studimit; Syllabus 2020-2021]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për programin Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” për gjatë tre viteve të fundit akademike janë si më poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik të PS	2018-2019		2019-2020		2020-2021	
	PAE	PAE	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	1	1	1	1	1	2
Prof.Assoc.	2	1	2	1	2	2
Dr/Phd	1	1	5	4	5	2
Gjithsej	4	3	8	6	8	6

Modulet mësimore në programin Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” mbulohen nga pedagogë të cilët kanë gradë shkencore. Bazuar në dokumentacion stafi në këtë program studimi është si më poshtë:

- 3 pedagogë me titullin Prof. Dr
- 4 pedagogë me titullin Prof. Assoc. Dr
- 7 pedagogë me gradën shkencore Dr

I gjithë stafi i angazhuar në mësimdhënie është me grada e tituj. **Pika 6 e nenit 59 te ligjit 80/2015 përmbushet.**

Nga verifikimi i personelit akademik i përfshirë në mësimdhënie, GVJ konstaton një qëndrueshmëri në stafin akademik.

Ngarkesa mësimore për personelin akademik me kohë të plotë në programin e studimit është 660 orë dhe e personelit akademik me kohë të pjesshme në programin e studimit është 240 orë.

Nga verifikimi i të dhënave statistikore, u konstatua se për tre vitet mbi 70% e ngarkesës mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv, PAE. Konkretisht:

Viti akademik	% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE
2018-2019	70%
2019-2020	73%
2020-2021	73%

Kërkesa ligjore që stafi akademik PAE të mbulojë të paktën 70% te ngarkesës përmbushet.

[Evidenca 16 Personeli akademik në programin studimit] [Evidenca 17 Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik]

Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me

Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se personeli akademik i programit ka njohuri në përputhje me natyrën e programit. Rezulton se personeli akademik i programit është i specializuar në fusha specifike të cilat mbulojnë në të gjitha lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, gjë që garanton formimin e specialistëve të fushës me aftësi të larta.

programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	[CV Emër Mbiemër]			
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<p>Universiteti Luarasi ka një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e institucione të sektorit publik</p> <p>Procedura e zhvillimit të praktikave profesionale është e rregulluar nëpërmjet udhëzuesit për zhvillimin e praktikës në të cilën përcaktohet dhe përgjegjësia për ecurinë e praktikave profesionale. Në fund të praktikës së realizuar nga studenti plotësohet dosja e saj e cila përmban gjithashtu të dhëna lidhur me pedagogun udhëheqës/ pritës dhe përshkrimin e udhëhëqesit për praktiken e kryer nga studenti. Universiteti Luarasi ka hartuar rregulloren e diplomimit dhe udhëzuesin e shkrimit të diplomës nga e cila [cit]: <i>Studenti gjatë punimit të temës së diplomës udhëhiqet nga një lektor i brendshëm ose i jashtëm i universitetit, i miratuar nga Dekani i Fakultetit.</i></p> <p>[Evidenca 21 Institucionet bashkepunuese me Luarasin] [Evidenca 23 Udhëzues për zhvillimin e praktikës/ pika 4 Strukturat përgjegjëse për ndjekjen e praktikës] [Evidenca 23 Udhëzues për zhvillimin e praktikës/ pika 9 Dosja e Praktikës] [Evidenca 26 Rregullore e diplomimit] [Evidenca 26.1 Udhëzuesi i shkrimit të diplomës]</p>			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	<p>Gjatë vizitës në ambientet e shkollës (klasat /labororet ku bëhet mesim nga studentet e këtij programi) GVJ konstatoi se mirëmbajtja e laboratorëve kryhej nga IT Nga intervistat me stafin akademik dhe studentët GVJ konstatoi se pedagogët e lëndës realizojnë dhe anën praktike të saj (laboratorët). Nga shqyrtimi i CV-ve stafi akademik është i përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike</p> <p>[Vizita në Institucion: Shenime ne vizite_7 Maj_Luarasi] [CV Emër Mbiemër].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përpunje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	<p>Programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, i hapur për herë të parë në vitin akademik 2018-2019, është në përshtatje me kërkesën e tregut për specialist të kësaj fushe të konstatuar nga institucioni në studimin.</p> <p>Bashkëpunimet me institucionet të ndryshme në fushën e teknologjisë së informacionit i japin mundësi dekanit të njësisë kryesore, njëkohësisht përgjegjës i departamentit ku zhvillohet programi të konsultohet në mënyrë të herëpashershme me përfaqësuesit e tregut të punës të fushës së teknologjisë së informacionit për përmirësimin e programit për t’iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohe kërkesave të tregut të punës.</p>

	[Evidenca 10 Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit] [Evidenca 21 Institucionet bashkepunuese me Luarasin; Marreveshje Bashkepunimi Emri Institucionit]			
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Universiteti Luarasi inkurajon studentët në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”. Sipas RVB Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i njësisë bazë si dhe Rektori kryejnë takime të vazhdueshme me studentët në lidhje me zhvillimin e programit mësimor ku shkëmbehen mendime dhe opinione për organizmin, funksionimin si dhe përmirësimin e tij. [Evidenca 27 Format i pyetesorit online] Evidenca 27.1 Analiza e pyetesorit te studenteve]			
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	GVJ konstaton se Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, si pjesë e detyrave të përcaktuara në rregulloren e saj ka mbajtjen e kontakteve me alumnet e institucionit, si shembuj pozitiv suksesi dhe model orientimi.. Sipas RVB diskutimet dhe propozimet nga studentët ALUMNI për përmirësimin e programeve të studimit janë të hapura dhe konstante. [Evidenca 28 Rregullore Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, neni 8 pika 12]			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	Kërkesa specifike lokale dhe kombëtare e përthithur nga analiza që ka bërë institucioni ka qenë një nga arsyet e hapjes së programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”. Bashkëpunimet me institucionet të ndryshme kërkimore e shkencore në fushën e teknologjisë së informacionit i japin mundësi UL të konsultohet në mënyrë të herëpashershme me ta për përmirësimin e programit në fushën e teknologjisë së informacionit. [Evidenca 21 Institucionet bashkepunuese me Luarasin] [Marreveshje Bashkepunimi Emri Institucionit] [Evidenca 10 Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhore të institucionit.	Objektivat formues të programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” përcaktojnë qartë objektivat e studimit dhe të kërkimit shkencor. Këto objektiva janë në përputhje me Strategjinë e Kërkimit Shkencor dhe prioritetet akademike të UL. Pjesë e objektivit formues të programit të studimit është që t’u japë mundësi studentëve që diplomohen në programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” që në të ardhmen të punësohen si: Drejtor IT në institucione publike dhe private; Menaxher Projektsh; Menaxher i Sistemeve të Informacionit. etj

	<p>Disa nga lëndët që përfshihen në këtë program dhe që garantojnë marrjen e njohurive për profesionet e synuara janë: Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; Hartim Dhe Menaxhim Projektesh Në Teknologji Informacioni; Menaxhim strategjik i teknologjisë dhe Inovacionit;. etj</p> <p>Ndër objektivat formues është gjithashtu: Sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre edhe ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike nëpërmjet vazhdimet të studimeve të ciklit të tretë (doktorata), duke rritur kështu mundësinë e tyre drejt kërkesave për një karriere profesionale-akademike. Një nga lëndët që përfshihet në këtë program dhe që garanton marrjen e njohurive mbi kërkimin shkencor të avancuar është: Metoda Kërkimi të Avancuara në Teknologji Informacioni. etj</p> <p>[Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi, Neni 7, Pika 1, 2, 3] [Evidenca 20 Strategjia e Kerkimit Shkencor] [Evidenca 20.2 Planifikimi i Kerkimit Shkencor] [Evidenca 7 Rregullore Programi, Neni 3: Objektivat Formues të programit]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Njësia kryesore Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit dhe njësia bazë Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit ku zhvillohet programi i studimit Msc ne “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” mbështetin bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtaritë e mësimdhënies të stafit dhe veprimtarinë kërkimore të stafit mësimdhënës. GJV konstaton, bazuar në dokumentat e dorëzuar nga GVB dhe vendosur në reference, se personeli akademik udhëzohet për përdorimin e Moodle gjatë mësimdhënies, përdorimin e librave në bibliotekën online të institucionit, nxitet dhe inkurajohet të reflektojë performancën shkencore në auditoret dhe veprimtarite mësimore interaktive me studentët.</p> <p>[Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial; Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Manual Perdoruesi Biblioteka Online], [Evidenca 32 Conference Proceedings 2020; Evidenca 20 Strategjia e Kerkimit Shkencor; Evidenca 20.2 Planifikimi i Kerkimit Shkencor]</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>GVJ konstaton se në dokumentin mbi planifikimin e kërkimit shkencor, është e specifikuar se në projektet kërkimore në grup të financuar nga UL inkurajohet dhe angazhimi i studentëve të nivelit Master. Gjithashtu në kuadër të projektit të financuar me fonde të WBF studentët inkurajohen të marrin pjesë në 4 konferencat e 4 vendeve te Ballkanit Perendimor.</p> <p>[Evidenca 20.2 Planifikimi i Kërkimit Shkencor] [Evidenca 32. 1 Evidenca 32. 1 Udhëzues_Konference Studentore_Luarasi] [Evidenca 50.1 Projekti WBF – Pershkrim]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Projekti i financuar nga WBF, ku UL është lider i ka dhënë mundësinë programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” të fokusohet në zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale.</p> <p>[Evidenca 50.1 Projekti WBF – Pershkrim]</p>
<p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore</p>	<p>GVJ konstaton se në dokumentin mbi planifikimin e kërkimit shkencor, është e specifikuar se UL financon projektet kërkimore në grup dhe bonuse për publikime</p>

e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	shkencore me faktor impakti. Gjithashtu bazuar në dokumentat konstatohet se UL përcakton mbështetje financiare për aktivitetet akademike kërkimore shkencore. [dok DVV Evidenca 20.2 Planifikimi i Kërkimit Shkencor] [dok DVV Evidenca 29 Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare; Evidenca 20.1 Buxheti mbi kerkimin shkencor]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	UL mbështet projektet kërkimore dhe ka bërë një sërë marrëveshesh me institucione të ndryshme kërkimore për bashkëpunim në punë kërkimore shkencore në fushën e teknologjisë së infomacionit. Ndër isntitucionet bashkëpunuese me UL përmendim: Universiteti Politeknik i Tiranës; Universiteti në Plock, Poloni; Universiteti i Bolonjës, Itali; AKCESKëty. [Evidenca 20 Strategjia e Kerkimit Shkencor; Evidenca 20.2 Planiflkimi i Kerkimit Shkencor] [Evidenca 21 Institucionet bashkepunuese me Luarasin; Marreveshje Bashkepunimi <i>Emri Institucionit</i>]			
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit ku zhvillohet programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” i përgjigjet kërkesave për projekte me karakter kërkimor shkencor. Projekti “Strengthening regional academic and research exchange” është një nga projekte e fituara ku personeli akademik i departamentit angazhohet si drejtues dhe pjesëmarrës dhe studentët si pjesëmarrës në të. [Vizita në Institucion: Shenime ne vizite_7 Maj_Luarasi] [Evidenca 50 Projekti WBF; Evidenca 50.1 Projekti WBF - Pershkrim]			
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	GVJ konstaton se: së fundmi financiar nga WBF është organizuar konferenca ndërkombëtare “Contemporary Trends and Multidisciplinary Issues in Nowadays Society” ku stafi akademik dhe studentët janë inkurajuar të marrin pjesë. [Evidenca 32 Conference Proceedings 2020] [Evidenca 32. 1 Udhezues_Konference Studentore_Luarasi]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit GJV konstaton se Universiteti Luarasi në nivel institucional ka hartuar udhëzuesin për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve. Udhëzuesi strategjik për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies 2019-2024 përfshin ndër të tjera në seksionin 'Standardet e zhvillimit profesional të stafit akademik' standardet: Mësimdhënie me në qendër studentin; Të nxëniti gjatë gjithë jetës; Standardet ESCO (Standardi Europian i Klasifikimit të Aftësive Profesionale dhe Punësimit/ European Skills, Competences, Qualifications and Occupations) etj [Evidenca 33 Udhëzues_Metodat Inovative te Mesimdhënies]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GJV konstaton se një nga objektivat strategjik të Universitetit Luarasi është "Cilësia dhe përformanca Akademike". Nga shqyrtimi i dokumentacionit GJV konstaton se strukturat përgjegjëse kanë zhvilluar mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. [Evidenca 8 Plani Strategjik, Objektivat] [Evidenca 27 Formati i pyetesorit online] [Evidenca 27.1 Analiza e pyetesorit te studenteve] [Evidenca 34 Format raporti vleresimi Pedagogu] [Evidenca 34. 1 Format raporti me komente vleresimi Pedagogu] [Evidenca 35 Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori]
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	GJV konstaton se institucioni përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies duke ju dhënë mundësi atyre të plotësojnë pyetësorë dy herë në vit dy javë përpara përfundimit të çdo semestri. NJBSC shpehet se kur ka pasur ankime ato janë trajtuar. [Evidenca 27 Formati i pyetesorit online] [Evidenca 34 Format raporti vleresimi Pedagogu]
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Njësisia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është struktura përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore në Universitetin Luarasi. Monitorimi dhe vlerësimi i performances së personelit akademik dhe ndihmes akademik realizohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani. Ata vlerësojnë performancën e personelit akademik me anë të formularit të vlerësimit, që plotësohet gjatë vizitës, në një orë mësimi. NJBSC analizon, mbi bazën e metodave statistikore, vlerësimet e cilësisë së mësimdhënies dhe gjeneron një raport individual për secilin anëtar të stafit akademik. Raporti komunikohet tek autoritetet drejtuese të Universitetit Luarasi. Ky raport i shkon gjithashtu përgjegjësit të njësisë bazë, i cili vë në dijeni të

	<p>vlerësimit të bërë nga studentët në mënyrë konfidenciale personelin akademik. NJBSC gjithashtu gjeneron një raport në nivel institucioni.</p> <p>[Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi, neni 73] [Evidenca 36 Manuali NJBSC]</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>GVJ, në bazë të dokumentave konstaton se rezultatet e vlerësimit të cilësisë përpunohen dhe përmbledhen në një raport. Këto rezultate raportohen me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p>NJBSC përgatit raportin e vlerësimeve periodike dhe i vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuar. Rezultatet e vlerësimit shërbejnë për përmirësimin e mësimdhënies në auditor të personelit akademik, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme ku promovohen shembuj të praktikave të mira.</p> <p>[Evidenca 27.1 Analiza e pyetësorit të studenteve] [Evidenca 34. 1 Format raporti me komente vlerësimi Pedagogu]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kurse, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ konstaton se personeli akademik i programit zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminarëve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale. Syllabusët e lëndëve miratohen në departament. Gjithashtu, plani mësimor është në përputhje me Rregulloren e Miratuar të programit.</p> <p>[Evidenca 7 Rregullore Programi] [Evidenca 11 Programi i Studimit; Syllabus 2020-2021] [Vizita në Institucion: Shenime në vizite_7 Maj_Luarasi]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” merr pjesë në trajnimet e orientuara në aspektet didaktike të mësimdhënies të organizuara nga Universiteti Luarasi.</p> <p>Gjithashtu gjatë punës me studentët ata nxiten të përdorin metoda inovative të mësimdhënies Personeli akademik merr në konsideratë nevojat e studentëve dhe bashkëpunon me ta për të ofruar një eksperiencë mësimdhënie-mësimnxënie sa më të mirë. Disa nga metodat e përdoruar gjatë mësimdhënies janë: simulimi, video, përdorimi software-ve të caktuar për të kryer analiza të pavarura etj.</p> <p>[Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin] [Evidenca 33 Udhezues_Metodat Inovative të Mësimdhënies] [Vizita në Institucion: Shenime në vizite_7 Maj_Luarasi;]</p>

Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	GVJ konstaton se Universiteti Luarasi angazhohet për përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit të tij akademik. Ai ka hartuar një udhëzues për këtë qëllim dhe zhvillon trajnime me qëllim përmirësimin e kompetencave didaktike. GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton se mjediset ku zhvillohet mësimi i programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”? mundësojnë për personelin akademik përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike. [Evidenca 33 Udhëzues_Metodat Inovative te Mesimdhënies] [Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin]			
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	GVJ pas analizimit të CV-ve të personelit akademik konstaton se personeli akademik i programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” zotëron përgatitje dhe kompetenca profesionale në mësimdhënie dhe në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. [CV Emër Mbiemër]			
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	GVJ konstaton se format e metodat e mësimdhënies vlerësohen nga eprori dhe studentët, kjo nëpërmjet komunikimit direkt me pedagogun apo përgjegjësin e njësisë bazë, mendime që shprehen nga përfaqësuesi i studentëve në mbledhje të njësisë bazë etj. Pyetësorët e hartuar në mënyrë periodike janë një mënyrë tjetër vlerësimi për metodat e mësimdhënies.			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe vizita në institucion. takimi me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se personeli akademik përdor metoda interaktive duke i bërë tërheqëse orët e mësimi. Këto metoda përfshijnë simulime, video, detyrë kursi, diskutime, prezantime etj. [Evidenca 35 Formulari i vlerësimit te pedagogut nga eprori] [Syllabus 2020-2021] [Vizita në Institucion: Shenime ne vizite_7 Maj_Luarasi]			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre	Personeli akademik është inkurajuar nga Universiteti Luarasi të zbatojë mësimdhënien me në qendër studentin, e cila krijon mundësi që studentët të ndërtojnë vetë dijet duke ndërvepruar dhe punuar në mënyrë të pavarur, ndërsa pedagogët e programit të shndërrohen në mbështetës të procesit mësimor. [Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave të hapësirave vlerëson se procesi mësimor e shkencor i programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” realizohet në hapësira të mjaftueshme, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p> <p>[Evidenca 38 Infrastruktura] [Vizita në Institucion: Shenime ne vizite_7 Maj_Luarasi]</p>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës së ambienteve të dedikuara për procesin mësimor, konstaton se klasat dhe laboratorët mësimorë janë të pajisur me kompjutera dhe projektorë.</p> <p>[Evidenca 38.1 Infrastruktura IT] [Vizita në Institucion: Shenime ne vizite_7 Maj_Luarasi]</p>
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	<p>Personeli akademik dhe studentët e Universitetit Luarasi përdorin sisteme IT të zhvilluara apo të përshtatura si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Moodle LMS & Microsoft Teams sisteme që mund të përdoret për të publikuar materialin mësimor, në lidhje me lëndët përkatëse, për të komunikuar pedagogët me studentët etj. • “Ngarkesa mësimore” i cili u vjen në ndihmë përgjegjësve të njësive bazë dhe dekanëve për ndarjen e ngarkesës mësimore e raportimin e saj. • “Sistemi i Menaxhimit Online të Bibliotekës Luarasi” i cili mundëson studentët dhe personelin akademik të kërkojnë dhe të rezervojnë libra për huamarrje. • “Sistemi i Vlerësimit online i pedagogëve dhe nxënësve” i cili i bjen në ndihmë NJBSC për vlerësimin e pedagogëve dhe lëndëve nga studentët • “Sistemi i kontratave”, i cili thjeshton procesin e regjistrimit të studenteve të rinj në Universitetin “Luarasi” dhe gjeneron automatikisht kontratën e studentit me UL. • “Luarasi-SharePoint”, i shërben UL për menaxhimin e dokumentacionit, një arkivë digjitale në të cilën gjenden të gjitha informacionet e UL. • “Panairi Virtual i Punes” i krijuar nga grupi i zhvillimit IT të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit. U jep mundësi punëdhënësve dhe punëmarrësve të takohen në një ambient virtual. <p>[Evidenca 24 Udhezues per perdorimin e Struktures se teknologjise se it - Manual Vleresinii i pedagogut Online;] [Evidenca 13 Raport per projektet Luarasi]</p>
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme	<p>Literatura bazë dhe e rekomanduar mbi të cilat organizohet dhe mbështetet procesi mësimor në programin Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme në fushën teknologjisë së informacionit. Duke qënë se programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” formon specialistë në një fushë që zhvillohet me hapa shumë të</p>

të parashikuara për programin e studimit.	shpejtë ka veshtirësi në gjetjen e literaturës në gjuhën shqipe, literatura e përdorur për këtë program është kryesisht në gjuhë të huaj. Literatura është e ruajtur fizikisht në bibliotekë. Literatura në gjuhën angleze është në formë elektronike. [Evidenca 25 Lista e literatures ne funksion te programit te studimit; GVB; Vizita në Institucion: Shenime ne vizite_7 Maj_Luarasi].
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Literatura ruhet fizikisht në bibliotekë. Biblioteka pasurohet në fillim të çdo viti akademik. Të gjithë lektorët mund të propozojnë titujt, që mund të shtohen në bibliotekë Në ndihmë të Bibliotekës në Universitetin Luarasi është vendosur laborator 106 në të cilin studentët mund të aksesojnë informacione kërkimore online. Sipas RVB, personeli akademik dhe studentët ciklit të dytë Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” aksesojnë librarinë online “Ulibrary” në të cilën gjenden të listuara libra dhe artikuj që lidhen me lëndët e trajtuara në këtë program studimi. [Evidenca 25. 1 Formular per pasurimin e literatures ne biblioteke] [Evidenca 25 Lista e literaturës ne funksion të programit te studimit] [Vizita në Institucion: Shenime ne vizite_7 Maj_Luarasi]
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Studentët e programit të ciklit të dytë të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” mund të përdorin 3 laboratorë për projekte apo për t’u përgatitur për provimet ndërmjetese dhe provimet finale + laboratorin 106 në të cilin mund të aksesojnë informacione kërkimore online për detyrat/projektet të kursit. [Evidenca 38.1 Infrastuktura IT]
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik dhe studentët në Universitetin Luarasi përdorin platformat Luarasi Moodle LMS & Microsoft Teams. Kjo platformë është konfiguruar dhe përshtatur në vitin akademik 2018-2019 dhe është shfrytëzuar dhe gjatë viteve akademik 2019- 2020/2020-2021. [Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial]
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Universiteti Luarasi ka vënë në dispozicion llogari Office 365 për personelin akademik dhe studentët. Office 365 i ofron studentëve dhe personelit akademik hapësirë vetjake të dedikuar në të cilën mund të ruhet dokumentacioni elektronik si dhe mundësinë e komunikimit elektronik nëpërmjet postës elektronike. “Luarasi-SharePoint”, i shërben gjithashtu UL për menaxhimin e dokumentacionit. [Evidenca 38.1 Infrastuktura IT] [Evidenca 13 Raport per projektet Luarasi]
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	Stafi akademik në programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” mbështet studentët në përzgjedhjen e temave dhe hartimin e tyre. Bazuar në fushën e ekspertizës së pedagogëve të programit studentët zgjedhin

	udhëheqësin dhe propozojnë fillimisht tre tema. Në bashkëpunim me udhëheqësin zgjedhin temën me të cilën do të punojnë. [Evidenca 7 Rregullore Programi] [Evidenca 26 Rregullore e diplomimit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Universiteti Luarasi në statutin e tij ka përcaktuar Njesinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore. NJBSC planifikon dhe organizon Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë, në kuadër të Universitetit “Luarasi”, në dy aspekte kryesore:</p> <p>(1) Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë të programeve të studimit</p> <p>(2) Vlerësimin e Brendshëm Institucional.</p> <p>NJBSC bashkëpunon me Dekanët e Fakulteteve për çdo vlerësim të brendshëm të cilësisë që organizon. Rezultatet e Raporteve të vlerësimit të NJBSC shërbejnë si bazë për zyrën e kërkimit shkencor për të hartuar dhe zbatuar programe të zhvillimit pedagogjik dhe didaktik të personelit akademik.</p> <p>[Evidenca 36 Manuali i NJBSC] [Evidenca 33 Udhezues_Metodat Inovative të Mesimdhënies] [Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin]</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	<p>Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (GVB) të cilësisë në çdo fakultet janë përgjegjëse për procesin e vetëvlerësimit dhe për implementimin e plan-veprimeve për sigurimin e cilësisë në kuadër të aktivitetve që ato kryejnë. Grupi i vlerësimit të brendshëm është ngritur me urdhër të dekanit të njësive kryesore dhe përgjegjësit të departamentit ku zhvillohet programi.</p> <p>Departamenti bën analiza periodike, mbi bazën e të cilave shqyrton situatën e përmbushjes së standardeve të cilësisë së mësimdhënies, duke lënë detyra për zgjidhjen e problematikave të mundshme.</p> <p>Bazuar në raportimet e vlerësimit të cilësisë dhe udhëzuesit strategjik të metodave inovative hartohen dhe zbatohen module trajnimi.</p> <p>[Evidenca 3 Urdher për ngritjen e GVB] [Evidenca 33 Udhezues_Metodat Inovative të Mesimdhënies] [Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin]</p>
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	<p>Universiteti Luarasi ka një udhëzues strategjik për periudhën 2019-2024 për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Një nga objektivat strategjik të Departamentit të Teknologjisë së</p>


	<p>Informacionit dhe Inovacionit është “Zbatimi i programeve dhe metodave të mësimdhënies bashkëkohore”</p> <p>[Evidenca 33 Udhezues_Metodat Inovative te Mesimdhënies] [Evidenca 19 Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti Luarasi mbështet kualifikimin në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor. Në Shkurt 2019 Universiteti Luarasi ka organizuar trajnimin “How to write and to publish an academic paper” me stafin Msc dhe Doktorant. Sipas RVB ky trajnim është organizuar edhe në periudhën Nëntor-Dhjetor 2020.</p> <p>[Moduli i trajnimit - How to write and to publish an academic paper]</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në udhëzuesin strategjik për periudhën 2019-2024 për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies Universiteti Luarasi ka planifikuar fushat e zhvillimit profesional të stafit akademik si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Mësimdhënia me në qendër studentin 2018-2019;</i> • <i>Vlerësimi dhe motivimi i studentëve 2019-2020;</i> • <i>Zhvillimi i të menduarit kritik të studentëve 2020-2021;</i> • <i>Zhvillimi i të menduarit krijues dhe problem-zgjidhja 2021-2022;</i> • <i>Roli i ndërveprimit student pedagog dhe student-student në efektivitetin e të nxëniet 2022-2023;</i> • <i>Puna në grupe, simulimet dhe zbatimi i teknologjisë në mësimdhënie 2023-2024;</i> <p><i>Institucioni ka realizuar trajnimin “Mësimdhënia me në qendër studentin”</i></p> <p>[Evidenca 33 Udhezues_Metodat Inovative te Mesimdhënies] [Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin].</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik ka realizuar me sukses programin e studimit. Ata angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies duke marrë pjesë në trajnime të organizuar nga institucioni dhe marrë në konsideratë rekomandimet e studentëve. Personeli akademik përdor metoda inovative në realizimin e tij, si p. sh. simulimet</p> <p>[Evidenca 19 Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit] [Vizita në Institucion: Shenime ne vizite_7 Maj_Luarasi] [Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin]</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacioneve dhe takimit me personelin akademik konstaton se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. Departamenti Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit nxit dhe mbështet stafin akademik. Departamenti ka vendosur si një nga objektivat e tij strategjik “Zbatimin e programeve dhe metodave të mësimdhënies bashkëkohore”.</p> <p>[Evidenca 19 Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit]</p>

Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në fazë të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Universiteti Luarasi përfshin në procesin mësimor lektorë dhe kërkues shkencorë nga institucionet me të cilat bashkëpunon si IAL apo AKCESK. Një nga objektivat strategjik të Departamenti Teknologjisë Së Informacionit Dhe Inovacionit është “Ndërtimi i rrjeteve të bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar” [Evidenca 26 Institucionet bashkepunuese me Luarasin] [Evidenca 22 Personeli akademik në programin studimit] [Evidenca 19 Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Notë përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e programit. Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> - 10% niveli i diskutimit në seminare - 20% detyrë kursi - 30% provimi i ndërmjetëm - 40% provimi përfundimtar [Evidenca 7 Rregullore Programi] [Syllabus 2020-2021]
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga takimi me studentët GVJ konstaton se personeli akademik, në fillim të çdo lënde informon studentët për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore dhe atë të programit. [Vizita në Institucion Shenime ne vizite_7 Maj_Luarasi: Takimi me studentët]
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë: Provimi i ndërmjetëm [30%], Niveli i pjesëmarrjes në seminare [10%], Detyra e kursit (projekte) [20%] Provimit përfundimtar [40%].



	[Evidenca 19 Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit] [Syllabus 2020-2021]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	GVJ ka shqyrtuar rregulloren e programit të studimit Msc në “Teknologji Informatike dhe Inovacioni” dhe ka konstatuar se në rregulloren e tij është përcaktuar se si realizohet testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Pika e fundit e nenit 7 të kësaj rregulloreje përcakton se “Niveli i suksesit të studentit vlerësohet mbi bazën e provimeve smestrare/vjetore, provimeve të fundvitit, detyrave të kursit, prezantimeve, aktivizimeve dhe projekteve. [Evidenca 7 Rregullore Programi]
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Testimi dhe vlerësimi në Universitetin Luarasi është realizuar kryesisht duke kombinuar metodat tradicionale (“pencil and paper”, vlerësimin me gojë) me mjetet elektronike (hartimi, postimi dhe prezantimi i detyrave të kursit/projekteve). Sipas RVB në disa lëndë është aplikuar testimi online duke përdorur Office 365 dhe Luarasi Moodle LMS. Nga takimi me studentët testimi online është realizuar në Teams, me kamera hapur. [RVB] [Vizita në Institucion Shenime në vizite_7 Maj_Luarasi: Takimi me studentët]
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se Universiteti Luarasi ka përcaktuar në rregulloren e Fakultetit se Dekani miraton komisionet e provimeve dhe të mbrojtjes së diplomave dhe Përgjegjësi i Departamentit miraton modalitete të vlerësimit dhe ngre komisionet e provimeve të cikleve përkatëse të studimeve në lëndët që mbulon departamenti. Sipas RVB komisionet e provimeve kanë së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	GVJ konstaton se provimet me shkrim sekretohen nga personeli i Sekretarise Mësimore. Në dokumentin GVJ citon: <i>Provimet me shkrim bëhen në fletë të sekretuara të cilat vulojnë nga sekretaria mësimore. Ato vendosen në zarf dhe hapen para studentëve dhe komisionit në momentin e fillimit të provimit. Studenti paraqitet në provim me një dokument identifikimi.</i> [Evidenca 6 Rregullore Fakulteti, Neni 6, 7] [Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi, Neni 72]
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe	Sipas RVB, vlerësimi i komponentëve të vlerësimit shoqërohet me komente dhe feedback nga pedagogu.

lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Një seancë sqaruese zhvillohet pas testit të ndërmjetëm dhe atij final. Në të qartësohen të gjitha kriteret e përdorura në vlerësim dhe studentët ballafaqohen me vlerësimin dhe cilesinë e punimeve të tyre.			
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Sipas RVB, të gjitha detyrat e kursit dhe projektet kontrollohen për plagjiaturë. Testet e ndërmjetme dhe ai final administrohen nga prania në auditor e dy pedagogëve, të cilët janë përgjegjës për moslejimin e kopjimit.			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit GJV konstaton se Universiteti Luarasi ka përcaktuar në se dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet jo më vonë se 2 (dy) javë nga data e zhvillimit të tyre. [Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi, Neni 74]			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit GJV konstaton se në rregulloren e universitetit përcaktohet e drejta e studentit për ankimimin e rezultateve të provimit. GJV citon nga ky dokument: <i>Studentët kanë të drejtë të paraqesin brenda tre ditëve nga marrja dijeni e vlerësimit, ankesë me shkrim tek Dekani i fakultetit përkatës me anë të së cilës kërkojnë të rishikohet vlerësimi i provimit.</i> GVJ konstaton se në rregulloren e universitetit përcaktohet se ankimimi i studentit i dërgohet Departamentit përkatës dhe Përgjegjësi i departamentit ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të përgjegjësit të departamentit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. [Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi, Neni 75]			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Mbështetur në rregulloren e programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” GJV konstaton se synohet formimi i ekspertëve dhe specialistëve në nivel cilësor në fushën e Teknologjisë së Informacionit. Bazuar në kurrikulën e tij dhe në syllabus-et e lëndëve të veçanta, ky program zhvillon dijet e studentëve dhe avancimin e tyre teknik e profesional në fushën e teknologjisë së informacionit. [Evidenca 7 Rregullore Programi] [Evidenca 11 Programi Studimit] [Syllabus 2020-2021;]
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së	Programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” zhvillon aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit.

informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi synon gjithashtu zhvillimin e aftësive të respektimit të parimeve etike dhe humane të zbatimit të teknologjisë së informacionit dhe inovacionit. [Evidenca 7 Rregullore Programi] [Syllabus Etika dhe Teknologjia]
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit analizon kompetencat profesionale të fituara nga studentët dhe i paraqet ato në: Analizën vjetore të tij, mbi arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të pritshme të të nxënës dhe aftësimit profesional në programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” [Evidenca 19 Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit]
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Sipas RVB dhe informacionit të marrë gjatë vizitës, në javën përpara testit ndërmjetës dhe në javën e 15 përpara testit final pedagogët bëjnë një përmbledhje të njohurive kryesore të trajtuara dhe orientojnë studentët mbi strukturën e testit ndërmjetës dhe atij final. Pedagogët përfshijnë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim.
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik i programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” është angazhuar edhe në veprimtari të tjera, si konferenca (seminare) të ndryshme, ku kanë prezantuar edhe teknologji të ndryshme në auditore të zgjeruara ku marrin pjesë jo vetëm studentet e programit të studimit por edhe studente dhe pedagoge nga programe të ndryshme studimi të fakulteteve të tjera. [Evidenca 37 Te dhena të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik]
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale.	GVJ vlerëson se personeli akademik transmeton dijet e tyre tek studentët duke demonstruar njohuritë dhe duke kryer ekspertiza laboratorike dhe praktikatat profesionale së bashku me studentët. Gjate zhvillimit të orëve mësimore, studentët realizojnë prezantime apo detyra kursi dhe projekte të ndryshme në fushën e teknologjisë së informacionit [Vizita në Institucion: Shenime në vizite_7 Maj_Luarasi]
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e	Sipas RVB dhe në bazë të vizitës së GVJ në institucion, personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orientojnë dhe instruktoren studentët në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. Detyra e kursit në lëndët përkatëse është një mundësi reale për zhvillimin e punës në grup. Përgjithësisht temat e detyrave të kursit janë raste studimi reale, në të cilat personeli akademik nxit studentët që ta trajtojnë studimin dhe ofrimin e zgjidhjes së problemeve duke u organizuar në skuadër. Detyrat e kursit pjesë e programeve mësimore të çdo lëndë krijojnë klimë të përshtatshme për mbështetjen dhe zhvillimin e ideve inovative.

shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	UL mbështet idetë inovatore të studentëve, krijon mundësi për zbatime të avancuara dhe mbështet financiarisht projekte kërkimore te suksesshme. [Syllabus 2020 2021 [Evidenca 20 Strategjia e Kerkimit Shkencor]] [Evidenca 13 Raport per projektet Luarasi] [Vizita në Institucion: Shenime ne vizite_7 Maj_Luarasi]			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	GVJ ka konstatuar se Universiteti Luarasi implementon disa projekte ERASMUS. Nëpërmjet tyre institucionin mundëson rritjen e shkëmbimit të eksperiencës dhe perfitimin prej praktikave më të mira të institucioneve bashkëpunuese perëndimore, njohuri te cilat më pas aplikohen në auditor apo transferohen tek anëtare te tjere te personelit akademik. [Evidenca 14 Marreveshjet Erasmus tabela] [Marreveshje Erasmus Universiteti i Bolonjës, Itali] [Marreveshje Erasmus Universiteti në Plock, Poloni]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Studentët e programit të studimit kishin filluar procedurën e temës së diplomës në fillim të semestrit të dytë. Universiteti Luarasi ka hartuar një rregullore diplomimi. Neni 6 i kësaj rregulloreje, Mbrojtja e Diplomës me temë, përcakton rregullat e posaçme të mbrojtjes së diplomës me temë për të cilin kanë të drejtë ta kenë si detyrim përmbyllës të gjithë studentët e programeve në ciklin e dytë të studimeve Master Shkencor në Universitetin Luarasi. Dokumenti udhëzues mbi punimin e diplomës, jep në mënyrë të detajuar çdo procedurë që ndiqet për temën e diplomës. Sipas RVB ky informacion i vihet në dispozicion studentit përpara aplikimit për punim diplome. [Evidenca 26 Rregullore e diplomimit] [Evidenca 26.1 Udhëzuesi i shkrimit te diplomes]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Studentët deklaruan se po asistoheshin nga udhëheqësit e temës. Dokumenti udhëzues përcakton se është udhëheqësi i diplomës që drejton, këshillon e konsulton. GVJ citon nga ky dokument: <i>‘Këshillat dhe rekomandimet e udhëheqësit të temës janë të rëndësishme veçanërisht për përcaktimin e një strukture të temës, nxjerrjen e grupçështjeve (krerëve apo kapitujve), trajtimin e problemeve teoriko-praktike, rekomandimin e literaturës, sugjerimin e mënyrave efikase të shfrytëzimit të literaturës, përcaktimin e afateve të punës dhe kontrollin e realizimit të detyrave si dhe formulimin dhe zhvillimin e një teze të strukturuar kërkimore’</i> [Evidenca 26.1 Udhëzuesi i shkrimit te diplomes]

<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Programi Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” ka detyrim përmbyllës mbrojtjen e diplomës me temë. Studenti e mbron temën para komisionit.</p> <p>Komisioni i ngritur për vlerësimin e temave të diplomës bazohet në standardet e hartimit të temave të diplomës të përcaktuara në udhëzuesin e shkrimit të diplomës dhe merr në konsideratë edhe vlerësimet me shkrim të udhëheqësit dhe oponentit.</p> <p>[Evidenca 26 Rregullore e diplomimit; Evidenca 26.1 Udhëzuesi i shkrimit te diplomes]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Dokumenti udhëzues përcakton se është udhëheqësi i diplomës që drejton, këshillon e konsulton. GVJ citon nga ky dokument: <i>Puna apo kontributi i udhëheqësit në realizimin e punimit mund e duhet të fillojë me zgjedhjen e temës e deri në përfundimin e punimit.</i></p> <p>Studentët deklaruan se ishin orientuar për temat që duhet të zgjidhnin.</p> <p>[Evidenca 26.1 Udhëzuesi i shkrimit te diplomes] [Shenime ne vizite_7 Maj_Luarasi.pdf]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion ambjentet e tij (laboratorët) ose lehtëson aksesin në ambjentet e institucioneve bashkëpunuese në mbështetje të realizimit praktik të punimit të diplomës.</p> <p>[Evidenca 38.1 Infstruktura IT] [Marreveshje Bashkepunimi Emri Institucionit]</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Studentët në UL, përfshirë edhe programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” mbështeten nga udhëheqësi i temës edhe në aspektin metodologjik të punës së tyre për hartimin dhe paraqitjen e punimit të diplomës. Sipas këtij udhëzuesi, orët e seancave metodologjike, të realizuara nga udhëheqësi i temës, duhet të trajtojnë edhe çështjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Përcaktimi i terreneve empirike të studimit;</i> • <i>Ndërtimi i hipotezave dhe verifikimi i tyre;</i> • <i>Trajtimi i anëve metodologjike si edhe i metodës së anketimit dhe intervistimit;</i> • <i>Ndërtimi i strukturës së punimit;</i> • <i>Përpilimi dhe debatimi i materialit bibliografik;</i> • <i>Përpunimi i metodave të paraqitjes sasiore (diagrame, kurba, etj), cilësore ose miks;</i> • <i>Hartimi i materialit prezantues para komisionit;</i> • <i>Debatimi i përfundimeve të studimit.</i> <p>Udhëheqësi i temës bën një vlerësim me shkrim të punimit i cili merret në konsideratë nga komisioni.</p> <p>[Evidenca 26.1 Udhëzuesi i shkrimit te diplomes, seancat metodologjike] [Evidenca 26 Rregullore e diplomimit]</p>

Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	<p>Në nenin 7 të rregullores së diplomimit përcaktohet se: Punimi i diplomës vlerësohet me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit.</p> <p>Vlerësimet me notë janë nga 1 në 10, ku nota më e ulët për kalim është 5.</p> <p>[Evidenca 26 Rregullore e diplomimit, Përfundimi dhe Vlerësimi i Temës]</p>			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	<p>Bazuar në procedurën e diplomimit studenti pajiset me diplomën përkatëse dhe suplementin e saj të miratuar nga Senati Akademik i Universitetit Luarasi, ne përputhje me udhezimet e Ministrise se Arsimit dhe Sportit.</p> <p>Aprovimi i modelit të diplomës bëhet nga QSHA, pasi përfundon procesi i akreditimit.</p> <p>[Evidenca 26 Rregullore e diplomimit, neni 8] [Evidenca 26.2 Model Diplome; Evidenca 26.3 Suplement Diplome Master i Shkencave] [Evidenca 26.4 Vendim Senati Akademik per miratimin e formes dhe suplementit te diplomes]</p>			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<p>Sipas RVB, në përfundim të studimeve, institucioni vendos në dispozicion të studentëve një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar, sipas vitit akademik përkatës, në rastet kur ai e kërkon këtë gjë.</p>			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	<p>Sipas RVB, Zyra e Arkivës mban një kopje të dokumentacionit të studentit për një periudhë të pacaktuar me qëllim pajisjen e studentëve me informacione nëse kërkohen.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se nga zyra e

<p>akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse janë mbledhur dhe ruajtur të dhënat e personelit akademik (me kohë të plotë apo të pjesshme) dhe administrativ të angazhuar me programin Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni" dhe janë krijuar dosje personeli për secilin prej tyre.</p> <p>Gjatë vizitës dhe takimit me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore u vlerësuan dosjet e personelit akademik të tre anëtarëve të personelit akademik të angazhuar me programin e studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni". GVJ konstaton se nga kjo zyrë janë mbajtur dhe ruajtur të dhëna për angazhimin e personelit akademik (me kohë të plotë apo të pjesshme) sipas në programin e studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni".</p> <p>GVJ konstaton se nga institucioni nuk janë regjistruar dhe paraqitur të dhënat e personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar në programin e studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni".</p> <p>[Evidenca 15 Personeli akademik në Njësine kryesore dhe Njësine përgjegjëse], [Evidenca 16 Personeli akademik në programin studimit] [Evidenca 40 Format i Dosjes personale të stafit].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se procedurat e rekrutimit të personelit akademik në Universitetin Luarasi janë rregulluar me rregullore të vecantë, në përputhje me detyrimet e akteve ligjore në fuqi. Në procesin e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik janë të përfshirë dhe departamenti i "Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit" dhe Fakulteti i "Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit" përgjegjës për programin e studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni". Procedurat e ndjekura për procesin e rekrutimit në Universitetin Luarasi janë përcaktuar në procedurat e rekrutimit të stafit të ri akademik në rregulloren në fuqi.</p> <p>[Evidenca 41 Rregullore e zyrës së burimeve njerëzore, pikat B, C, D dhe E]. [Evidenca 41 Rregullore e zyrës së burimeve njerëzore pika B].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se në rregulloren e zyrës së burimeve njerëzore janë parashikuar procedura dhe kritere të posaçme dhe specifike të punësimit të personelit akademik të programit të studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni", të cilat propozohen nga drejtuesi i departamentit që mbulon programin e studimit, dhe miratohen nga rektori i Universitetit Luarasi. Procedura që ndiqet është e hapur nëpërmjet publikimit të vendeve vakante në faqen zyrtare të Universitetit Luarasi, rrjetet sociale dhe në shtypin e shkruar.</p> <p>[Evidenca 41 Rregullore e zyrës së burimeve njerëzore pika B] [Evidenca 41 Rregullore e zyrës së burimeve njerëzore pika B] [https://luarasi-univ.edu.al/zyra-e-burimeve-njerzore/].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se në procedurën e</p>


të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	<p>ndjekur nga Universiteti Luarasi për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit akademik janë plotësisht të përfshirë departamenti i "Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit" dhe Fakulteti i "Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit" përgjegjës për programin e studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni" nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • paraqitjes së kërkesës dhe kritereve të përgjithshme dhe të posacme për plotësimin e vakancës/vakancave në përputhje me modulet dhe përmbajtjen e programit dhe kualifikimin e personelit të kërkuar; • përfaqësimit në shumicë të departamentit që mbulon programin në komisionin ad-hoc për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve fitues të vakancës/vakancave. <p>[Evidenca 41 Rregullore e zyres se burimeve njerezore pika B] [Evidenca 6 Rregullore Fakulteti TII, pika 7 dhe 9].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi. GVJ konstaton se është ndërmarrë angazhimi i duhur dhe është krijuar një mjedis dhe infrastrukturë e përshtatshme për realizimin e detyrave në mënyrë profesionale nga personeli i institucionit.</p> <p>Në përdorim të personelit të angazhuar me programin e studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni" janë vënë në dispozicion zyra me hapësira të mjaftueshme dhe të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (kondicionim, ndricim dhe postë të pajisura me kompjuter personal).</p> <p>Ngarkesa javore e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni" nuk i kalon ngarkesën prej 10 orë mësimore në javë, ku përfshihen dhe angazhimet në programet e tjera të studimit duke u lënë në dispozicion kohën e nevojshme për kualifikime të mëtejshme apo për kërkimin shkencor. Por ashtu sikurse është theksuar me lart personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën në programin e studimit në masën mbi 70 %</p> <p>[Evidenca 38.2/42.1 Kontratë Qiraje Konvikti i Gjuhëve të Huaja] [Dok DVV Evidenca 38 Infrastruktura] [Evidenca 38.1 Infrastruktura IT] [Evidenca 17 Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik]</p>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se Universiteti Luarasi në funksion të një prej objektivave kryesorë të misionit të tij ka mbështetur</p>

personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	zhvillimin dhe kualifikimin e mëtjshëm të personelit të angazhuar me programet e studimit, me trajnime të zhvilluara nga Universiteti Luarasi apo në institucione të tjera, si në vend dhe jashtë tij.			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	<p>Ngarkesa javore e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” është një tregues i angazhimit institucional për mundësimin e kohës në dispozicion për kualifikime të mëtjshme dhe kërkimin shkencor. Gjatë vizitës dhe takimeve në IAL u informuam për mbështetjen e dhënë nga Universiteti Luarasi në angazhimet në mësimdhënie dhe kualifikime profesionale brenda dhe jashtë vendit të dy pedagogeve (I.B dhe A.D.). Universiteti Luarasi ka organizuar gjatë viteve akademike 2018-2020, aktivitete për kualifikimin dhe kërkimin shkencor, si dhe trajnime kualifikimi specifike të personelit akademik në metodat inovative të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjive të reja, si dhe në aftësitë në fushën e kërkimit dhe shkrimit shkencore.</p> <p>[Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi, neni 3] [Evidenca 37 Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik] [Evidenca 17 Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik] [Evidenca 33 Udhëzues_ Metodrat Inovative të Mësimdhënies] [Moduli i trajnimit - How to write and to publish an academic paper] [Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin].</p>			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se nga ana e institucionit është zbatuar parimi i angazhimit të burimeve njerëzore, personelit akademik në këtë program inovativ, sipas ekspertizës në mësimdhënie dhe në fushën specifike, në funksion të përbushjes së programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”.</p> <p>[CV-të e stafit të programit të studimit] [Evidenca 40 Dosje personeli] [Evidenca 17 Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik].</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” në funksion të veprimtarisë mësimdhënëse.</p> <p>GVJ vizitoi ambientet e Universitetit "Luarasi", një ndërtesë prej 5 kate, me një sipërfaqe funksionale afro 2822 m², e marrë me qera deri më 29.06.2033.</p>

studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Mësimi fizik dhe online (në periudhën e mbylljes së pandemisë) në programet e studimit Master në Universitetin Luarasi zhvillohet në orarin 16-20, ndërkohë për programet e studimit Bachelor zhvillohet në orarin 8-15.</p> <p>[Evidenca 38 Infrastruktura] dhe [Dok DVV Evidenca 38.1 Infrastruktura IT].</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për programin në funksion të veprimtarisë mësimdhënëse. Auditorët, klasa, laboratorët, biblioteka, sallat e leximit, si dhe ambientet e tjera në funksion të mësimdhënies - mësimnxënies të programin e studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni" janë të pajisura me pajisje elektronike (kompjuter, videoprojektor, dërrasë interaktive, pajisje fotokopjimi dhe printimi) dhe janë të mbështetura me teknologjitë e informacionit dhe komunikimit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentët, personeli akademik dhe administrativ kanë akses të plotë në rrjetin LAN dhe Wi-Fi të Universitetit • Platforma Office 365(sharepoint-efektiv plotësisht që prek vitit akademik 2019-2020, email dhe aplikacionet e tjera) • Një platformë e re e-learning "Portali i pedagogut dhe studentëve", zgjidhje "Moodle LMS" një produkt i zhvilluar inhouse në Universitetin "Luarasi" që është vënë në funksion prej vitit akademik 2019-2020 dhe ka pësuar përmirësime të mëtejshme; • Biblioteka online, një produkt tjetër i zhvilluar inhouse, funksional në Universitetin Luarasi, nëpërmjet së cilës bëhet rezervimi online i librave fizikë; • Katër salla laboratorësh të pajisur me kompjuter (mbi 25 kompjutera) me akses në intranet dhe internet. <p>Të gjitha ambientet mbështeten nga infrastruktura qendrore dhe e hostuar TIK që administrohen të gjitha nga personeli TI i Universitetit Luarasi.</p> <p>[Evidenca 38 Infrastruktura IT] [Evidenca 38.1 Infrastruktura IT] [Evidenca 13 Raport për projektet Luarasi]. [Evidenca 24.1 Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial.] [Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Manual Përdoruesi Biblioteka Online.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion të procesit mësimor të programit të studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni" 4 laboratorë me videoprojektor, dërrasë interaktive, pajisje fotokopjimi dhe printimi, si dhe mbi 25 kompjutera për secilin laborator, me akses në intranet dhe internet, të cilat mirëmbahen nga personeli TI i Universitetit Luarasi. Studentët, personeli akademik dhe administrativ kanë akses të plotë në rrjetin LAN dhe Wi-Fi të Universitetit</p>



Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion 4 laboratorë me mbi 25 kompjutera secili me akses në një rrjet të përbashkët dhe internet. Në këto laboratore janë të instaluar një disa programe të licensuar dhe disa open source.</p> <p>Bazuar në informacionin shtesë të sjellë nga UL, GVJ konstaton se software-t që disponohen janë të mjaftueshëm për mbështetjen e pjesës laboratorike, në përputhje me kërkesat aktuale të lëndëve të programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”.</p> <p>[Evidenca 38 Infrastruktura] [Evidenca 38.1 Infrastruktura IT] [Evidenca Shkresë Komete për DRVJ Msc në Teknologji Informacioni dhe Inovacion, Universiteti Luarasi]</p>			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se institucioni në mbështetje të programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” bashkëpunon në zbatim të marrëveshjeve të nënshkruara të bashkëpunimit apo është në proces nënshkrimi të marrëveshjeve të bashkëpunimit me një sërë institucionesh dhe kompani të rëndësishme dhe të njohura në fushën e Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, si psh: Protik, AKCESK, Akademia e Sigurisë, DPPSH, ICT Media, Tetra Solution etj. Në këto istitucione dhe kompani shtetërore dhe private, studentët e programit të studimit kanë zhvilluar praktikat mësimore.</p> <p>Universiteti Luarasi ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi nën thirrjet për projektin ERASMUS⁺, për personelin akademik dhe studentë në disa Universitete: Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti i Plock, Poloni dhe Universiteti i Bolonjës, Itali.</p> <p>[Evidencat 21 Institucionet bashkëpunuese me Luarasin] [Evidenca 22 Institucionet ku janë kryer praktikat mësimore] [Evidenca 14 Marreveshjet Erasmus tabela] [Marrëveshjet me Universitetet - tre].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton që biblioteka është e lokalizuar në katin e tretë, me një sipërfaqe 43 m ² , në dispozicion dhe të studentëve të programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” gjatë orarit

barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>9.00-19.00. Këtë ambient mund ta shfrytëzojnë si sallë leximi deri në 20 studentë. Në të njëjtën kohë, si salla leximi për këtë program përdoren dhe ambiente të tjera, përfshirë sallat e seminareve, të pajisuara me kompjutera dhe ku ofrohet akses i pakufizuar në internet.</p> <p>[Evidenca 38.3/42 Planimetria] [Evidenca 38 Infrastruktura] [Evidenca 38.1 Infrastruktura IT].</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se në bibliotekën e institucionit disponohet një koleksion prej 20 tekste në literaturë fizike në shqip për lëndët e formimit bazë dhe formuese, si dhe cikli i leksioneve për pjesën më të madhe të lëndëve të programit të studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni".</p> <p>Pjesa më e madhe e literaturës e vënë në dispozicion për literaturën bazë dhe të rekomanduar për lëndët e programit të studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni" është në gjuhën angleze dhe në format elektronik (pdf) prej afro 33 librash. Studentëve të programit të studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni" u është vënë në dispozicion literatura për lëndët e programit nëpërmjet platformave Luarasi-moodle LMS dhe/ose Microsoft Teams. Në të njëjtën kohë literaturën fizike të kufizuar në shqip dhe anglisht, studentët e këtij programi mund ta rezervojnë nëpërmjet aplikacionit biblioteka online.</p> <p><u>GVJ rekomandon se është e nevojshme që në vazhdimësi të pasurohet literatura fizike për lëndët e programit të studimit në përputhje me programet e azhornuara të lëndëve.</u></p> <p>[Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial]. [Evidenca 25 Lista e Literaturës në funksion të programit të studimit] [Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Manual Përdoruesi Biblioteka Online].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se për studentët e programit të studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni" ofrohet shërbimi falas dhe me akses të barabartë nëpërmjet aplikacionit biblioteka online, në intranet për rezervimin online të literaturës së disponueshme në bibliotekë. Për këtë qëllim është vënë në funksion dhe sistemi Luarasi - Moodle LMS, në linkun moodle.luarasi.edu.al dhe platforma Microsoft Teams nëpërmjet të cilit është vënë në dispozicion të studentëve literatura në format elektronik për lëndët e programit të studimit. Në të njëjtën kohë studentët mund të konsultojnë librarinë e Universiteteve e vënë në dispozicion nga MASR në linkun https://ulibrary.rash.al/.</p> <p>[Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Manual Përdoruesi Biblioteka Online] [Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial]</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se disponohet dhe është në funksion aplikacioni/sistemi <i>Biblioteka online</i> që administron fondin e literaturës fizike dhe në dispozicion të programit të studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni", e vlefshme në intranetin e institucionit. Aplikacioni</p>

shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	<p>Biblioteka online është i hapur dhe i pakufizuar për të gjithë studentët e programeve të studimit, përfshi dhe Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, sipas procedurës paraprake të regjistrimit dhe dhënies së aksesit në sistem, pas regjistrimit dhe hapjes së kartelës përkatëse të studentit, stafit akademik apo administrativ. Nëpërmjet këtij aplikimi ky fond është në dispozicion të studentëve për rezervimin paraprak online të tyre.</p> <p>[Evidenca 38 Infrastruktura], [Evidenca 38.1 Infrastruktura IT] [Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Manual Perdoruesi Biblioteka Online]</p>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se në bibliotekën e institucionit, disponohen një numër i kufizuar tekstesh në shqip, të literaturës bazë të programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”. Institucioni ka të rregulluar nëpërmjet formularit përkatës procedurën që duhet të ndiqet nga departamenti dhe fakulteti për rekomandimin e porosisë së blerjes së literaturës fizike bazë, të rekomanduar apo plotësuese.</p> <p><i>GVJ rekomandon se IAL duhet të hartojë dhe zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues për programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” sipas nevojave dhe kërkesave për këtë program studimi.</i></p> <p>[Evidenca 25 Lista e Literaturës në funksion të programit të studimit] [Evidenca 25.1 Formular për pasurimin e literaturës në bibliotekë]</p>			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve shërbimet e bibliotekës çdo ditë gjatë orarit 9.00-19.00, ndërkohë që mësimi në programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” zhvillohet 16.00-20.00. Në të njëjtën kohë ambienti i bibliotekës mund të shfrytëzohet si sallë leximi nga 20 studentë. Në të njëjtën kohë si salla leximi për këtë program përdoren dhe ambiente të tjera, përfshirë sallat e seminareve, të pajisura me kompjutera dhe ku ofrohet akses i pakufizuar në internet.</p> <p>[Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Manual Perdoruesi Biblioteka Online], [Evidenca 42 Planimetria], [Evidenca 38 Infrastruktura] [Evidenca 38.1 Infrastruktura IT].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ

Adresa: “Rruga e Durrësit” Nr 219, Tiranë


E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 50

<p>cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>konstaton se institucioni disponon dhe ka në përdorim sistemin/programin e kontratave nëpërmjet të cilit menaxhohet informacioni personal për ecurinë e detyrimeve financiare të kontratave të studentëve të programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre. Në të njëjtën kohë nga ana e institucionit për menaxhimin e anës akademike të studentëve është në funksion sistemi i menaxhimit të njohurive Pedagog/student Luarasi, bazuar në zgjidhjen Moodle LMS.</p> <p>Ndërkohë GVJ konstaton nga informacioni i vënë në dispozicion dhe gjatë vizitës se UL nuk ka aktualisht një sistem të brendshëm funksional për menaxhimin e sekretarisë mësimore. GVJ u informua se UL po punon për përshtatjen dhe implementimin e sistemit të menaxhimit të sekretarisë mësimore “Pitagora”.</p> <p><i>GVJ sugjeron marrjen e masave të nevojshme për zhvillimin dhe vënien në funksion të sistemit të brendshëm të sekretarisë mësimore për menaxhimin e plotë të aktivitetit mësimor të studentëve nga regjistrimi deri në përfundim të ciklit të studimeve dhe për këtë program studimi.</i></p> <p>[Evidenca 13 Raport për projektet Luarasi, Sistemi i kontratave] [Evidenca 13 Raport për projektet Luarasi, Moodle LMS] [Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial]</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton që IAL përdor për administrimin e dokumentacionit të institucionit që lidhet dhe me programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” sistemin/ aplikacionin e intranetit të brendshëm, një sistem i përshtatur në Microsoft Sharepoint nëpërmjet së cilës mundësohet administrimi i informacionit sipas hierarkisë dhe roleve të autorizuara të përshtatur për përdorimin si aplikime desktop dhe mobile, për stafin administrativ, akademik dhe ndihmësakademik. Ndërkohë institucioni për administrimin e aktivitetit akademik përdor sistemin e ngarkesës së pedagogut, nëpërmjet së cilit të gjithë drejtuesit e departamenteve dhe fakulteteve, përfshirë ato që mbulojnë programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” mbështeten në administrimin e përcaktimit dhe raportimit të ngarkesës mësimore për çdo pedagog, lëndë, semestër dhe program studimi.</p> <p>[Evidenca 13 Raport për projektet Luarasi, Sistemi i ngarkesës mësimore dhe Luarasi Sharepoint]) [Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it - Manual Ngarkesa e Pedagogut].</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton që institucioni përdor për administrimin e dokumentacionit të institucionit që lidhet dhe me programin e studimit sistemin/aplikacionin e intranetit të brendshëm, një sistem i përshtatur, mbi zgjidhjen sharepoint, nëpërmjet së cilës mundësohet administrimi i informacionit sipas hierarkisë dhe roleve të autorizuara të përshtatur për përdorimin si aplikime desktop dhe mobile, për stafin administrativ, akademik dhe ndihmes-akademik.</p>



	<p>Ndërkohë institucioni për administrimin e informacionit dhe dokumentacionit të personelit akademik dhe të studentëve të programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” ka vënë në përdorim sistemin/ programin Luarasi Moodle LMS, që ka akses të dedikuar për secilin nga stafi akademik dhe studentët dhe ka të regjistruar dhe të përditësuar informacionin e nevojshëm për lëndët e programit të studimit, për çdo semestër, akses në literaturën e lëndëve, si dhe pedagogët përgjegjës për lëndët. Në këtë platformë organizohet dhe administrohet procesi, materialet, format e vlerësimit të dijeve dhe forumet e diskutimit online të studentëve me pedagogun në funksion të zhvillimit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>[Evidenca 13 Raport për projektet Luarasi, Sistemi Moodle LMS dhe Luarasi Sharepoint] [Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial]</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se institucioni ka vënë në funksion dhe ka përdorur që në semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019, për realizimin dhe administrimin e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet stafit akademik dhe studentëve platformën/sistemin Luarasi Moodle LMS. Me anë të moduleve të dedikuara të kësaj platforme mundësohet komunikimi i personalizuar, në kohë reale në platformë mes pedagogëve dhe studentëve. Në këtë platformë organizohet dhe administrohet procesi, materialet dhe format e vlerësimit të dijeve të studentëve nga pedagogu në funksion të zhvillimit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Informacioni administrohet në formë të personalizuar për çdo përdorues, pedagog apo student.</p> <p>[Evidenca 13 Raport për projektet Luarasi(Sistemi Moodle LM)] [Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial].</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton që institucioni përdor për monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe mundësimin e gjenerimit të raportimeve individuale të personelit akademik dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët nga sistemet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sistemi i Ngarkesës së Pedagogut <p>Nëpërmjet Sistemi të ngarkesës së pedagogut monitorohet në kohë reale ngarkesa e çdo lënde dhe pedagogu.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Luarasi Moodle LMS. <p>Nëpërmjet sistemit Luarasi Moodle LMS organet drejtuese dhe titullarët monitorojnë mbarëvajtjen e procesit akademik nëpërmjet gjenerimit të raporteve dhe të dhënave statistikore nga ky sistem.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sistemin e Vlerësimit Online të Pedagogut, nëpërmjet të cilit zhvillohet 2 herë në vit, para përfundimit të semestrit procesi i vlerësimit anonim të pedagogëve. Nga ky sistem gjenerohen në kohë reale raporte, të dhëna për organet drejtuese

	<p>dhe titullarët për performancën e çdo pedagogu, numrin e studentëve të përfshirë për çdo proces vlerësimi.</p> <p>Sic u theksua dhe më lart në raport , nga GVJ u konstatua UL nuk ka aktualisht një sistem të brendshëm funksional për menaxhimin e sekretarisë mësimore dhe se po punon për përshtatjen dhe implementimin e sistemit të menaxhimit të sekretarisë mësimore “Pitagora”.</p> <p><u>GVJ sugjeron marrjen e masave të nevojshme për zhvillimin dhe vënien në funksion të sistemit të brendshëm të sekretarisë mësimore për menaxhimin e plotë të aktivitetit mësimor të studentëve nga regjistrimi deri në përfundim të ciklit të studimeve dhe për këtë program studimi, kjo dhe për të garantuar monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe që mundëson raportime individuale dhe të dhëna të konsoliduara dhe në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</u></p> <p>[Evidenca 13 Raport për projektet Luarasi] [Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it -Manual Ngarkesa e Pedagogut] [Evidenca 13 Raport për projektet Luarasi] [Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial] [Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së teknologjisë së it-Manual Vlerësimi i pedagogut Online]</p>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se institucioni ka në funksion platformën e faqes zyrtare Web, një faqe dinamike në të cilën publikohet informacion mbi programet e studimit, strukturën organizative të institucionit, fakulteteve, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme në lidhje me jetën akademike, studentore, ato të zhvilluara në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Informacioni i publikuar azhurnohet në mënyrë të vazhduar dhe për momentin është vetëm në gjuhën shqipe, pasi po vijohet më zhvillimin dhe përditësimin e informacionit të faqes dhe në gjuhën angleze. [https://luarasi-univ.edu.al/]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se institucioni harton buxhetin vjetor dhe afatmesëm në muajin tetor të çdo viti, i cili miratohet nga Senati dhe Bordi i Administrimit, në zbatim të Kreut IV, të Rregullore Luarasi dhe Planit Strategjik 2016-2020. Në projektbuxhet përcaktohet një raport i tillë i të ardhurave dhe shpenzimeve që përcakton dhe rezervat e nevojshme për

<p>programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>shpenzimet e nevojshme dhe që garantojnë qëndrueshmëri financiare për institucionin.</p> <p>Nga institucioni u informuam se për shkak të natyrës së IAL-ve jopublike raportet janë hartuar në bazë institucioni dhe jo sipas programeve të studimit. GVJ e konstatoi në raportin e paraqitur për financimin dhe menaxhimin e burimeve financiare të IAL deri në vitin 2019-2020, ku është dhënë dhe një parashikim për financimin e buxhetit për vitin akademik 2019-2020 sipas fakulteteve të IAL.</p> <p>[Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi] [Evidenca 8 Plani Strategjik 2016-2020] [Evidenca 6 Rregullore KU Luarasi] [Evidenca 29 Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare].</p>												
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se IAL ka hartuar planin e financimit në nivel institucional dhe fakultetesh për vitin 2019-2020 dhe jo sipas programeve të studimit, ku janë përfshirë të gjitha të ardhurat dhe financimet e ndryshme, si dhe shpenzimet e kostove të studimit, kjo e raportuar me arsyetimin jo vetëm nga përmasat e institucionit por edhe me faktin se personeli në shumicën e rasteve angazhohet në programe të ndryshme studimi dhe për këtë arsye ka qenë e vështirë hartimi i tyre sipas programeve të studimit.</p> <p>Nga të dhënat në nivel IAL shpenzimet për studentët, për vitin 2019-2020 janë:</p> <table><tr><td></td><td>2018-2019</td><td>2019-2020</td></tr><tr><td>Kosto për student/ Euro</td><td>1.061</td><td>1.164</td></tr><tr><td>Kosto e mësimdhënies për Student Euro</td><td>728</td><td>717</td></tr><tr><td>Të ardhurat/ Student Euro</td><td>1.503</td><td>1.489</td></tr></table> <p>Në raportin vjetor akademik 2019-2020 janë raportuar të ardhurat dhe financimet e ndryshme, si dhe shpenzimet për Fakultetin TII. Për vitin akademik 2020- 2021, të ardhurat parashikohen të jenë në masën afro 96,9 % nga “Tarifat për dhe gjatë shkollimit” dhe afro 3,1 % “Të ardhura të tjera nga veprimtaria”. Shpenzimet operative më së shumti mbulojnë në masën 77 % pagat dhe shperblimet e personelit, si dhe sigurimet, 16 % shpenzime operationale dhe afro 1.5 % për “Shpenzime për Kërkim Shkencor e bibliotekën”.</p> <p>[Evidenca Raport vjetor 2019-2020] [Evidenca 29 Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare].</p>		2018-2019	2019-2020	Kosto për student/ Euro	1.061	1.164	Kosto e mësimdhënies për Student Euro	728	717	Të ardhurat/ Student Euro	1.503	1.489
	2018-2019	2019-2020											
Kosto për student/ Euro	1.061	1.164											
Kosto e mësimdhënies për Student Euro	728	717											
Të ardhurat/ Student Euro	1.503	1.489											
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se institucioni si pjesë e Grupit Hysenbelliu ka kryer auditimin, nga një ekspert kontabël i autorizuar të pasqyrave financiare që paraqesin aspektet materiale dhe pozicionin financiar të kësaj shoqërie në datën 31 Dhjetor 2019.</p> <p>Nga audituesi është nxjerrë konkluzioni se pasqyrat financiare paraqesin drejtë aspektet materiale dhe pozicionin financiar të kësaj shoqërie në datën 31 Dhjetor 2019, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë</p>												

Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	datë, në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar në Shqipëri. Në këto pasqyra financiare konstatohet se burimi i të ardhurave të institucionit janë pagesat nga tarifat e studimit dhe pagesat e studentëve për shërbimet e tjera. [Evidenca 30 Pasqyrat Financiare 2019] [Evidenca 31 Raporti Audituesit 2019]			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se institucioni nëpërmjet pasqyrave financiare të raportuara për vitin 2019, të certifikuara dhe nga audituesi, ekspert kontabël i autorizuar, ka patur burim kryesor të të ardhurave të institucionit pagesat nga tarifat e studimit dhe një pjesë e vogël nga pagesat e studentëve për shërbimet e tjera. <u>GVJ rekomandon që IAL të angazhohet për gjetjen e burimeve të tjera për financimin e programit të studimit.</u> [Evidenca 30 Pasqyrat Financiare 2019] [Evidenca 31 Raporti Audituesit 2019]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se institucioni ka hartuar, miratuar dhe zbaton politika dhe procedura që duhet të ndjekë për programin e studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni" që janë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe të përcaktuara në Statusin dhe Rregulloren e Institucionit, rregulloren e Fakultetit të Informacionit dhe Inovacionit, si dhe rregulloren e veçantë të Programit të studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni".</p>

	<p>Institucioni kujdeset që nga regjistrimi i studentëve dhe pajisja e tyre me numër matrikullimi, krijimi i dosjes së plotë të studentit dhe deri në dalje duke u kujdesur për diplomimin dhe suplementin e diplomës.</p> <p>GVJ kërkoi disa dosje studentësh (random) dhe konstatoi se ishin në përputhje me kërkesat ligjore.</p> <p>[Udhëzimi Nr.18, datë 21.5.2018 “Per procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në vitin akademik 2018-2019”, i ndryshuar, Kreu IV/4 dhe IV/5] [Evidenca 9 Statuti Universitetit Luarasi, Kreu V Organizimi i studimeve], [Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi, Kreu VI Organizimi i studimeve], [Evidenca 6 Rregullore Fakulteti, Kreu V Organizimi i studimeve] [Evidenca 7 Rregullore Programi].</p>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar, miratuar dhe zbaton politika dhe procedura për të garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student dhe studentët e programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, që mbështeten në Statusin e Institucionit, Rregulloren e institucionit, si dhe rregulloren e Fakultetit të Informacionit dhe Inovacionit.</p> <p>[Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi Kreu VII Studentët], [Evidenca 6 Rregullore Fakulteti Kreu V Organizimi i studimeve] [Evidenca 7 Rregullore Programi, Kreu II Përmbajtja e Programit].</p>
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konfirmon se në zbatim të politikave dhe procedurave të Institucionit ka përdorur një sërë mjetesh dhe metodash bashkëkohore për publikimin e kriterëve dhe procedurave të aplikimit, pranimit dhe regjistrimit të studentëve, procesit të vlerësimit të dijeve si dhe diplomimit të studentëve të programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”. Kriteret dhe procedura e aplikimit janë publikuar përpara fillimit të vitit akademik në faqen zyrtare të institucionit, në fushatat informuese mediatike të zhvilluara në shkolla të mesme të ndryshme jo vetëm të Tiranës, broshurat informuese, si dhe gjatë procesit të informimit dhe këshillimit në zyrat përkatëse në Institucion.</p> <p>[Evidenca 6 Rregullore Fakulteti, Kreu V Organizimi i studimeve] [Evidenca Evidenca 43 Të dhëna nga Faqja zyrtare e WEB (për kriteret përkatëse)] [Evidenca 44 Guida Luarasi] [www.luarasi-univ.edu.al].</p>
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se në zbatim të përcaktimit nenit 5 të Rregullores se Programit ka përcaktuar kriteret specifike të pranimit të studentëve në programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”. Këto kriteret të veçanta për pranimin janë publikuar në faqen zyrtare të Web të UL dhe u janë komunikuar para fillimit të vitit akademik studentëve dhe të interesuarve në zyrat përkatëse të institucionit.</p> <p>[Udhëzimi Nr.18, datë 21.5.2018 “Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në vitin akademik 2018-2019”, i ndryshuar, Kreu IV/4 dhe IV/5], [Evidenca 6 Rregullore</p>

	Fakulteti, Kreu VI Pranimi, matrikullimi dhe transferimi i studentëve], [Evidenca 7 Rregullore Programi, Kreu II Përmbajtja e Programit], [Evidenca 43 Të dhëna nga Faqja zyrtare e WEB (për kriteret përkatëse)] [www.luarasi-univ.edu.al] .			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ ka konstatuar se institucioni përpara fillimit të vitit për programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” ka informuar dhe udhëzuar publikun dhe studentët e interesuar për kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin në programin e studimit nëpërmjet informimit në faqen Web të institucionit, fushata informuese dhe publicitare në televizione, broshurave të informimit, si dhe informimit të publikut të interesuar dhe në zyrat dhe ambientet e institucionit. [Udhëzimi Nr.18, datë 21.5.2018 “Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në vitin akademik 2018-2019”, i ndryshuar, Kreu IV/4 dhe IV/5] [Evidenca 6 Rregullore Fakulteti, Kreu VI Pranimi, matrikullimi dhe transferimi i studentëve], [Evidenca 7 Rregullore Programi, Kreu II Përmbajtja e Programit] [Evidenca 43 Të dhëna nga Faqja zyrtare e WEB (për kriteret përkatëse)] [www.luarasi-univ.edu.al] .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se për programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” ka vënë në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik në javën e parë të orientimit të organizuar nga fakulteti dhe me pjesëmarrjen e stafit akademik që mbulon programin në fjalë, si dhe gjatë orientimit dhe prezantimit të syllabusit të lëndës, nga çdo pedagog, në javën e parë të mësimi. Në të njëjtën kohë syllabuset e lëndëve janë ngarkuar nga secili pedagog në platformat Luarasi Moodle LMS/ Microsoft Teams. [Evidenca 7 Rregullore Programi, Kreu II Përmbajtja e Programit], [Evidenca 45 Kalendar Akademik] [Syllabuse të lëndëve të programit të studimit 2018-2021].
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se institucioni në zbatim të Udhëzimit Nr.18, datë 21.05.2019, të ndryshuar të MASR, ka parashikuar procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme në rregulloren e programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”.

	[Evidenca 7 Rregullore Programi, Kreu II Përmbajtja e Programit], [Evidenca 45 Kalendar Akademik] [Evidenca Tabelat permbledhese per Aneks_RVB, Tabela 21] [Syllabuse të lëndëve të programit të studimit 2018-2021]			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se institucioni në zbatim të përcaktimeve në rregulloren e programit të studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni" ka informuar studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve të programit, në mënyrë të përgjithshme për infrastrukturën në dispozicion të programit në javën e orientimit dhe në mënyrë specifike gjatë prezantimit të secilës lëndë dhe syllabusit përkatës ku paraqitet ky informacion. [Evidenca 7 Rregullore Programi, Kreu II Përmbajtja e Programit], [Evidenca 45 Kalendar Akademik] [Syllabuse të lëndëve të programit të studimit 2018-2021]			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se institucioni në zbatim të përcaktimeve në rregulloren e programit të studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni" ka informuar studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit, e cila organizohet si punim diplome i vlerësuar me notë dhe me 18 Kredite / 8 ECTS. [Evidenca 7 Rregullore Programi, Kreu II Përmbajtja e Programit], [Evidenca 26.1 Udhezuesi i shkrimit te diplomes] [Evidenca Evidenca 26 Rregullore e diplomimit]			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni publikon dhe informon mbi programin e studimit, Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni" në faqen zyrtare të internetit të institucionit, nëpërmjet fushatave të vazhdueshme të publicitetit, botimit dhe shpërndarjes së broshurave informuese dhe informacioni të dhënë gjatë vizitave të të interesuarve në institucion. [Evidenca Evidenca 43 Të dhëna nga Faqja zyrtare e WEB (për kriteret përkatëse)], [Evidenca 44 Guida Luarasi] [www.luarasi-univ.edu.al].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se institucioni ka


kohëzgjatjen e programit të studimeve.	vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion dhe dokumentacionin e nevojshëm për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” si dhe për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtarisë formuese. Në javën e parë të orientimit, në zbatim të rregullores së programit të studimit, krahas prezantimit të programit të studimit, me të gjithë elementët nga dekani dhe përgjegjësi i departamentit, realizohet prezantimi i objektivave dhe njohurite dhe aftësitë e fituara nga secila lëndë. Në javën e parë të mësimin në secilën lëndë bëhet prezantimi i detajuar i lëndës, përmbajtja dhe veprimtaritë e parashikuara formuese. Ky informacion u bëhet i ditur studentëve edhe në faqen zyrtare të informacionit, broshurave informuese dhe syllabuset e lëndëve, të cilat ngarkohen nga secili pedagog dhe në platformat Luarasi Moodle LMS / Microsoft teams.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	[Evidenca Evidenca 43 Të dhëna nga Faqja zyrtare e WEB (për kriteret përkatëse)] [Evidenca 44 Guida Luarasi] [Evidenca 45 Kalendar Akademik] [Syllabuse të lëndëve të programit të studimit 2018-2021] [www.luarasi-univ.edu.al].
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se struktura specifike e institucionit, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës e përbërë dhe nga 3 pedagogë 1 për çdo Fakultet informon studentët mbi mundësitë e punësimit, këshillon, mbështet dhe orienton studentët e programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” për tregun e punës. Studentët gjatë vitit akademik 2018-2021, janë udhëzuar dhe kanë përfituar nga marrëveshjet me institucione private dhe shtetërore për praktika mësimore dhe janë ftuar dhe në aktivitetet e përbashkëta të realizuara si një rastin e bashkëpunimit për praktikat mësimore dhe studimore dhe aktivitetet e tjera institucionet bashkëpunuese. Përgjithësisht studentët e këtij programi studimi janë të punësuar. Në mënyrë të veçantë për ata studentë të këtij programi studimi që nuk janë të punësuar janë informuar në mënyrë të vazhdueshme për mundësi të ndryshme punësimi me email, si dhe janë mbështetur dhe këshilluar për përgatitjen e CV, letrave të motivimit, përgatitjen për intervistë punësimi. [Evidenca 28 Rregullore Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, pika 7 dhe 8], [Evidenca 28.1 Zyra e karrierës], [Evidenca 28.2 LUARASI Udhëzues nga Qendra e Karrierës dhe Alumni] [Evidenca 21 Institucionet bashkëpunuese me Luarasin].
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se institucioni informon studentët nëpërmjet burimeve të ndryshme mbi organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën dhe infrastrukturën mbështetëse, si dhe shërbimet e ofruara nga institucioni në funksion të realizimit të programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”. Që në javën e parë të orientimit studentët njihen me kalendarin akademik, orarin mësimor, ambientet, mjetet dhe shërbimet në funksion të programit të studimit.

	[Evidenca Evidenca 43 Të dhëna nga Faqja zyrtare e WEB (për kriteret përkatëse)], [Evidenca 44 Guida Luarasi] [Evidenca 45 Kalendar Akademik] [Evidenca 46 Orari] [Syllabuse të lëndëve të programit të studimit 2018-2021] [www.luarasi-univ.edu.al].			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se institucioni gjatë vitit akademik 2018-2021 ka zhvilluar që në vitin akademik 2018-2019 dhe ka përmirësuar sistemin LUARASI Moodle LMS për të shërbyer si sistem i menaxhimit të brendshëm të informacionit për publikimin e informacionit të nevojshëm dhe të programit e studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni" dhe aksesimin e informacionit të nevojshëm në distancë me kredencialet përkatëse nga studentët e programit të studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni". [Evidenca Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial] dhe [Evidenca 13 Raport për projektet Luarasi].			
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit dhe dokumentacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se institucioni disponon dhe ka në përdorim sistemin/programin e kontratave nëpërmjet të cilit menaxhohet informacioni personal për ecurinë e detyrimeve financiare të kontratave të studentëve të programit të studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni", nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre. Në të njëjtën kohë nga ana e institucionit për menaxhimin e anës akademike të studentëve është në funksion sistemi i menaxhimit të njohurive Pedagog/student Luarasi, bazuar në zgjidhjen Moodle LMS. Ndërkohë nga GVJ u konstatua nga informacioni i vënë në dispozicion gjatë vizitës se po vijohet me përshtatjen dhe është duke u implementuar sistemi i menaxhimit të sekretarisë mësimore "Pitagora", me funksion për menaxhimin e plotë të informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit mësimor të studentëve. <u>GVJ rekomandon zhvillimin dhe vënien në punë të sistemit të menaxhimit të sekretarisë mësimore për menaxhimin e plotë të informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit mësimor të studentëve.</u> [Evidenca 13 Raport për projektet Luarasi, Sistemi i kontratave] [Evidenca 13 Raport për projektet Luarasi, Moodle LMS] [Evidenca 24 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së it-Moodle tutorial]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Null përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se në sekretarinë mësimore të institucionit mbahen dhe regjistrohen të dhëna vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre. Në këtë programi studimi të dhënat e studentëve të regjistruar dhe diplomuar janë:</p> <table><tr><th>Sipas vitit akademik</th><th>Studente te regjistruar</th><th>Studente te transferuar</th><th>Studente te diplomuar</th></tr><tr><td>2018-2019</td><td>15</td><td>-</td><td>13</td></tr><tr><td>2019-2020</td><td>12</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>2020-2021</td><td>8</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Total</td><td>35</td><td></td><td></td></tr></table> <p>[Evidenca 47 Të dhëna të plota për regjistrimin e studentëve] [Evidenca Tabelat permbledhese per Aneks_RVB].</p>	Sipas vitit akademik	Studente te regjistruar	Studente te transferuar	Studente te diplomuar	2018-2019	15	-	13	2019-2020	12	1	-	2020-2021	8	-	-	Total	35		
Sipas vitit akademik	Studente te regjistruar	Studente te transferuar	Studente te diplomuar																		
2018-2019	15	-	13																		
2019-2020	12	1	-																		
2020-2021	8	-	-																		
Total	35																				
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se siç u cilësua dhe në kriterin e parë, institucioni disponon të dhëna vjetore për studentët e regjistruar, transferuar dhe diplomuar. Nga IAL disponohen dhe statistika për tërheqjet apo largimet nga programi i studimit para përfundimit të studimeve. Në këtë program studimi ka pasur një student të ç’regjistruar në vitin akademik 2019-2020.</p> <p>[Evidenca 47 Të dhëna të plota për regjistrimin e studentëve] [Evidenca Tabelat permbledhese per Aneks_RVB] [Evidenca RAPORT VJETOR 2019-2020]</p>																				
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se institucioni regjistron manualisht për momentin(deri në vënien në punë të sistemit të menaxhimit të sekretarisë mësimore) dhe disponon të dhëna në sekretarinë mësimore për studentët gjatë zhvillimit të programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” nga pranimi, deri në përfundim të studimeve. Këto të dhëna statistikore përdoren nga IAL, fakulteti apo departamentit për analiza të ndryshme.</p> <p>[Evidenca 47 Të dhëna të plota për regjistrimin e studentëve] , [Dok DVV Evidenca Tabelat permbledhese per Aneks_RVB]e [Evidenca RAPORT VJETOR 2019-2020]</p>																				
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit dhe dokumentacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se siç është cilësuar edhe më lart në raport, për menaxhimin e informacionit të brendshëm sekretaria mësimore përdor për të dhënat statistikore të studentëve, si dhe akseson dhe realizon verifikimin e tyre për momentin në paketën Office. Institucioni ka në fazë zhvillimi Sistemin Pitagora për sekretarinë mësimore me funksion për menaxhimin e plotë e aktivitetit akademik të studentëve nga regjistrimi deri në përfundim të ciklit të studimeve dhe për këtë program studimi.</p>																				



<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit dhe dokumentacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin "Luarasi", GVJ konstaton se institucioni ka hartuar për studentët e programit të studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni" në 3 vitet akademike 2018-2021, raporte analitike mbi profilin, cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe nivelin dhe cilësinë e punësimit të tyre, si dhe masat që duhet të merren në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve të matur të programit të studimit. Krahas regjistrimit të të dhënave të punësimit të studentëve të këtij programi studimi, nga departamenti është realizuar një pyetësor online në vitet akademike 2019-2020 dhe 2020- ku rezultoi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentë të punësuar ishin 87.5% dhe të papunë ishin 12.5%; • Të punësuar në sektorin publik ishin 33.3% dhe në sektorin privat ishin 54.2%; • Në sektorin privat 33.3% e të punësuarve ishin femra dhe 66.7% meshkuj; • 37.5% e studentëve punojnë në profesionin Specialist IT; • 12.5% e studentëve punojnë në profesionet data entry/data administrator /database. <p>[Evidenca 12 Te dhena tabelore per punesimin real te studenteve] [Evidenca 47 Të dhëna të plota për regjistrimin e studentëve] [Evidenca Tabelat permbledhese per Aneks_RVB] [Evidenca RAPORT VJETOR 2019-2020]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se institucioni ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese në aktet ligjore dhe rregullatore të institucionit, përkatësisht në statusin dhe rregulloren e institucionit, ku specifikohet qartë parashikimi i përfshirjes dhe angazhimit, si dhe roli i Këshillit studentor për përfshirjen dhe angazhimin të përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese.</p> <p>[Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi, neni 63-64] [Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi, pika 57]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se institucioni ka</p>




studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	garantuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimarrëse e këshilluese në aktet ligjore dhe rregullatore të institucionit, përkatësisht në statusin dhe rregulloren e institucionit, përkatësisht në senatin akademik, komisionet e perhershme, këshillin e etikës dhe në NjBSC. [Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi, pika 6, 9, 12] [Evidenca 36.2 Vendim mbi ngritjen e NJSBC]
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar planin mësimor të përgatitur për programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, në zbatim të VKM Nr.41, datë 24.01.2018 duke mbajtur në fokus ngarkesën akademike të studentëve në këtë program studimi sipas përcaktimeve. Pas analizës së planit mësimor të këtij programi studimi (Tabela 10) paraqesin një ndarje korrekte të lëndëve në semestra dhe vite akademike, në kreditet përkatëse dhe orët në auditor dhe për studim individual të studentit. Gjithashtu, vërehet një ndarje e orëve në auditor për aktivitetet formuese në 10 orë/ECTS. Në brezin e parë të studentëve të këtij programi studimi ka pasur një rast të njohjes së studimeve të pjesshme në vitin akademik 2019-2020. [VKM Nr.41, datë 24.01.2018] [Evidenca Tabelat permblledhese per Aneks_RVB, Tabela 10]
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se bazuar në statutin e institucionit, studentët janë të përfshirë në të gjitha organet kolegjiale vendimarrëse. Përtej përfaqësuesve të studentëve në organet e mësipërme, institucioni garanton mbledhjen e mendimeve, opinioneve dhe sugjerimeve të studentëve me anketimet periodike në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Në këtë program studimi, Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” nuk është realizuar asnjë proces rishikimi apo përmirësimi i këtij programi studimi. [Evidenca Tabelat permblledhese per Aneks_RVB, Tabela 11]
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se institucioni u mundëson studentëve së pari vënien në dispozicion dhe informimin mbi kriteret dhe procesin e vlerësimit të dijeve në programin e studimit, Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, në javën e informimit dhe gjatë javës së parë të mësimit për çdo lëndë. Studentëve ju mundësohet nëpërmjet procedurave të rregulluara e drejta e barazisë dhe transparencës në vlerësimin dhe kontrollin e dijeve, si dhe mundësisë së ankimimit të rezultatit, kërkesës për rishikim të tij. Studentët e këtij programi studimi, e pohuan edhe në takimin me përfaqësues të studentëve gjatë vizitës në institucion që janë të informuar me procedura dhe rregullat që mund të ndjekin nëse dëshirojnë të ankimojnë një vlerësim. Në

	<p>përfundim të çdo semestri, studentët nëpërmjet anketimeve japin opinionin e tyre për të gjitha aspektet e jetës studentore brenda institucionit.</p> <p>[Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi, Neni 75 Ankimimi i rezultateve të provimit]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” ka marrë pjesë në aktivitete kërkimore dhe shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën specifike që mbulojnë, në aktivitetet kërkimore të organizuara nga UL ose universitete dhe qendra kërkimore në vende europiane dhe të tjera. Së fundmi është organizuar konferenca ndërkombëtare “Contemporary Trends and Multidisciplinary Issues in Nowadays Society”, e financuar nga WBF, ku janë inkurajuar të marrin pjesë stafi akademik dhe studentët. Në të njëjtën kohë ata kanë marrë pjesë në publikime të rikujve shkencorë dhe në revista të indeksuara si psh: Scopus.</p> <p>[Evidenca 32 Conference Proceedings 2020] [Evidenca 32. 1 Udhezues_ Konferenca Studentore _Luarasi] [Evidenca 37 Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik]</p>
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se UL me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta ka nëshkruar marrëveshje partneriteti nën programin Erasmus + me IAL të huaja si “Pan European University”, Bilat, Sllovakia Universiteti Shtetëror i Shkencave të Aplikuara, në Plock, Poloni dhe Universiteti i Bolonjës, Itali.</p> <p>[Evidenca Marrëveshje Bashkepunimi Emri i Universitetit]</p>
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se në dokumentin mbi planifikimin e kërkimit shkencor është specifikuar se në projektet kërkimore në grup të financuar nga UL inkurajohet dhe angazhimi i studentëve të nivelit Master. Gjithashtu në kuadër të projektit të financuar me fonde të WBF, UL ka inkurajuar studentët që me mbështetjen e personelit akademik të marrin pjesë në 4 konferencat e 4 vendeve të Ballkanit Perëndimor.</p> <p>[Evidenca 20.2 Planifikimi i Kërkimit Shkencor] [Evidenca 32.1 Udhezues_ Konferenca Studentore _Luarasi] [Evidenca 50.1 Projekti WBF– Pershkrim]</p>

Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se UL mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve shkencore të personelit akademik dhe studentëve e mbështetur dhe me buxhet nga UL dhe me planifikimin e kërimit shkencor është e specifikuar se në projektet kërkimore në grup të financuar nga UL inkurajohet dhe angazhimi i studentëve te niveli Bachelor/Master. Gjithashtu nga UL inkurajohet publikimi ne revista shkencore me faktor impakti duke i caktuar dhe një bonus në vlera monetare sipas indeksit të revistës shkencore. Kjo evidentohet dhe nga publikimet e personelit akademik. [Evidenca 20.1 Buxheti mbi kerkimin shkencor] [Evidenca 20.2 Planifikimi i Kërimit Shkencor] [Evidenca 37 Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik]			
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se në UL studentët mbështeten dhe motivohen të angazhohen në studime inovative. Në kuadër të projektit të financuar me fonde të WBF, UL ka inkurajuar studentët që me mbështetjen e personelit akademik të marrin pjesë në 4 konferencat e 4 vendeve te Ballkanit Perendimor. [Evidenca 32.1 Udhezues_Konference Studentore _Luarasi] [Evidenca 50.1 Projekti WBF– Pershkrim]			
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se personeli akademik bazuar dhe në rregulloret përkatëse mbështet studentët gjatë punës për përgatitjen e diplomës. [Evidenca 7 Rregullore Programi] [Evidenca 26 Rregullore e diplomimit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.7

Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se UL ka ndjekur një politikë bashkëpunimi me IAL të tjera në vend dhe jashtë me qëllim rritjen e aktiviteteve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve të programit të studimit. Fokusi kryesor në këto bashkëpunime janë kërkimi shkencor, projektet, inovacioni si dhe rritjen e mundësisë së punësimit të studentëve. Personeli akademik i UL dhe i IAL të huaja mbështeten në procesin e informimit për programet kombëtare dhe ndërkombëtare të financimit të mobilitetit dhe institucionet shqiptare të kërimit. UL ka rritur bashkëpunimin me IAL të tjera në kuadër të projekteve



	<p>ndërkombëtare nën Erasmus + Mobility dhe jo vetëm. Në të njëjtën kohë ka vijuar përpjekjet për bashkëpunime të reja nëpërmjet aplikimit për projekte Erasmus + KA2 Capacity Building. Projekti i fundit i fituar dhe Financuar nga Western Balcan Fund (WBF), ku UL është Universiteti lider së bashku me 3 IAL të tjera të Ballkanit Perëndimor. Ky projekt ka në fokus parësor mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve, kërkimin shkencor, si dhe mundësi të reja bashkëpunimi ndërkombëtar. Ky projekt përveç mbështetjes së mobilitetit dhe kërkimit shkencor ka mbështetur organizimin e Workshopeve për karrierën dhe punësimin e studentëve.</p> <p>[Evidenca 13 Raport per projektet Luarasi], [Evidenca 14 Marreveshjet Erasmus tabela] [Evidenca 50 Projekti WBF dhe Evidenca 50.1 Projekti WBF – Pershkrim]</p>
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se UL dhe Departamenti DII ka mbështetur dhe inkurajuar personelin akademik në punën e tyre kërkimore individuale dhe në grup. Mbështetja e studentëve në njohjen dhe aplikimin e metodave kërkimore ka ndihmuar ata në punën për diplomën dhe i ka përgatitur studentët e interesuar për vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve.</p>
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se UL nëpërmjet bashkëpunimit të njëjësive përkatëse Zyra e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Zyrës së Studentit dhe Zhvillimit të Karrierës ka ftuar studentë të Luarasis apo dhe kërkues të rinj, në dhe jashtë UL për të marrë pjesë në konferenca shkencore ndërkombëtare apo projekte ku është e angazhuar UL. Në projektin aktual ku UL është lider të financuar nga WBF, në Konferencën e Parë Ndërkombëtare të organizuar, ka promovuar punën kërkimore të studiuesve të rinj, me dhënie cmimesh bazuar në renditjen e vlerësimit të punimeve të tyre shkencore nga Bordi Shkencor i organizimit të konferencës. Në faqen Web të UL publikohen nga Zyra e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë informacioni i nevojshëm për projektet aktuale të UL, si dhe mundësitë e aplikimit për projekte të reja në vend dhe jashtë.</p> <p>[Evidenca 13 Raport per projektet Luarasi] [Evidenca 50 Projekti WBF] [Evidenca 50.1 Projekti WBF – Pershkrim] [Evidenca 28.2 LUARASI Udhezues nga Qendra e Karrieres dhe Alumni]</p>
Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se UL ka organizuar aktivitetet shkencore ku ka ftuar kërkues të huaj për mbajtjen e leksioneve të hapura mbi tema inovative, me interes për zhvillimin e kërkimit shkencor, si dhe bashkëpunimin me DII, njësi që mbulon dhe programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”. UL ka publikuar këtë informacion në faqen Web të UL.</p> <p>[Evidenca 51 Leksione të hapura dhe aktivitete të tjera]</p>
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se UL në përputhje dhe me planin strategjik të tij në funksion të arritjes së objektivave për ofrimin e një edukimi sa më cilësor ka ndjekur një politikë bashkëpunimi me IAL të tjera në vend</p>

angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	dhe jashtë me qëllim rritjen e aktiviteteve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve të programit të studimit. Në këtë kuadër bashkëpunime të UL me IAL të tjera në kuadër të projekteve Erasmus favorizojnë mobilitetin e studentëve dhe personelit akademik dhe të programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”.			
	[Evidenca 8 Plani Strategjik] [Evidenca 14 Marreveshjet Erasmus tabela]			
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se UL për të rritur profilin ndërkombëtar ka zgjeruar bashkëpunimin me IAL të tjera në kuadër të projekteve ndërkombëtare nën Erasmus + Mobility dhe jo vetëm si si “Pan European University”, Bilat, Sllovaki Universiteti Shtetëror i Shkencave të Aplikuara, në Plock, Poloni dhe Universiteti i Bolonjës, Itali ku janë ftuar për leksione të hapura personel akademik në UL. Në të njëjtën kohë ka vijuar përpjekjet për bashkëpunime të reja nëpërmjet aplikimit për projekte Erasmus + KA2 Capacity Building. Projekti i fundit i fituar dhe Financuar nga Western Balcan Fund (WBF), ku UL është Universiteti lider së bashku me 3 IAL të tjera të Ballkanit Perëndimor. Ky projekt ka në fokus parësor mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve, kërkimin shkencor, si dhe mundësi të reja bashkëpunimi ndërkombëtar.			
	[Evidenca 14 Marreveshjet Erasmus tabela], [Evidenca 51 Leksione të hapura dhe aktivitete të tjera] [Evidenca 50 Projekti WBF dhe Evidenca 51 Projekti WBF – Pershkrim]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.8 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se UL se në përputhje dhe aktet rregullatore të tij ka ngritur strukturën specifike e institucionit, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës e përbërë dhe nga 3 pedagogë 1 për çdo Fakultet, në përputhje dhe me parashikimet në rregulloren e saj informon studentët mbi mundësitë e punësimit, këshillon, mbështet dhe orienton studentët e UL, përfshi dhe programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”. Kjo zyrë organizon, menaxhon dhe drejton procesin e rekrutimit të studentëve të rinj, mban marrëdhënie të vazhdueshme me këshillat studentorë, drejton procesin e këshillimit të studentëve, mban komunikim me tregun e punës, si dhe ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve.

	[Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi, Neni 85] [Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi, Neni 103] [Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi], [Evidenca 5 Rregullore e Universitetit Luarasi] [Evidenca 28 Rregullore Zyra e Studentit dhe Keshillimit te Karrieres] dhe [Evidenca 28.1 Zyra e karrieres]
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se UL se Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës e përbërë dhe nga 3 pedagogë 1 për çdo Fakultet përbën burimin primar të informacionit për studentët. Informacionet jepen të personalizuar në rast kërkesë apo nevojë nga studentët por jepen kryesisht edhe në formë udhëzuesish apo manualesh të publikuara në faqen ueb përkatëse. Në këtë kuadër edhe gjatë takimit në institucion, studentët konfirmuan që në UL orientohen jo vetëm në aspektin akademik por edhe atë shoqëror e social. Ndërkohë gjatë takimit me përfaqësuesit e kësaj zyre u informuam që në zbatim të planit vjetor të punës po vijohet me dizenjimin dhe implementimin e platformës online për ZSKK. [Evidenca 28 Rregullore Zyra e Studentit dhe Keshillimit te Karrieres] [Evidenca 28.1 Zyra e karrieres]
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit dhe dokumentacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se institucioni nëpërmjet ZSKK ka ofruar shërbimin e këshillimit të karrierës duke mirëpritur studentët në mënyrë të vazhduar, duke i orientuar qoftë në drejtim të përfundimit me sukses të procesit mësimor(krahas personelit akademik), por dhe në orientimin dhe zgjedhjen e praktikës profesionale, si dhe orientimin në tregun dhe vendet e lira të punës , mbështetjen si dhe këshillimin e nevojshëm në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe përgatitjen për intervistë. Mund të përmendim angazhimin e plotë të kësaj zyre në informimin e studentëve mbi klubet dhe kalendarin e aktiviteteve studentore, anëtarësimin e tyre në klube dhe pajisjen me certifikatën përkatëse. Po nga kjo zyrë është përgatitur dhe është vënë në funksion të studentëve udhëzuesi nga Qendra e Karrieres dhe Alumni. UL po zhvillon një sistem të ri “Panairi virtual i punës”, i cili do të ndikojë pozitivisht jo vetëm në rritjen e partneriteteve të UL me bizneset në Shqipëri e më gjerë por një kohësisht do tu ofrojë bizneseve një urë të re komunikimi digjital me studentët, punëmarrësit e tyre të ardhshëm [Evidenca 28 Rregullore Zyra e Studentit dhe Keshillimit të Karrierës] [Evidenca 28.1 Zyra e karrierës] [Evidenca 28.2 LUARASI Udhezues nga Qendra e Karrieres dhe Alumni] [Evidenca 13 Raport per projektet Luarasi, 6 Panairi virtual i punës].
Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se ZSKK, si pjesë e detyrave të përcaktuara në rregulloren e kësaj zyre ndjek dhe mbështet studentët e diplomuar në programin e studimit, duke grumbulluar, përpunuar dhe regjistruar të dhënat mbi punësimin dhe cilësinë e punësimit të tyre në raport me programin e studimeve. Këto të dhëna, që mbahen aktualisht në bënë pjesë e ALUMNI, të cilat ZSKK ua vë në dispozicion studentëve, drejtuesve të Institucionit, bizneseve të



	<p>interesuara për punësim të tyre, me konfirmimin paraprak nga studenti. Nga ZSKK janë mbajtur të dhënat e punësimit real të tyre.</p> <p>[Evidenca 28 Rregullore Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës] [Evidenca 28.2 LUARASI Udhezues nga Qendra e Karrieres dhe Alumni] [Evidenca 12 Te dhena tabelore per punesimin real te studenteve].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ ARTEVE

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se janë hartuar dhe zbaton politika, struktura dhe procedura, në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe ato rregullatore të institucionit. Misioni i arsimit të lartë është të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me standardet europiane. Një ndër funksionet e Senatit Akademik është të garantojë sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionin e arsimit të lartë. Një nga funksionet e Senatit akademik është të ngrejë njësinë e brendshme të sigurimit të cilësisë përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. Universiteti Luarasi ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si një strukturë e përhershme me Vendimin e Senatit Akademik të KU Luarasi</p> <p>[Ligji nr. 80/2015, datë 22.07.2015, Neni 1, 38 dhe 103] [Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi, neni 14 dhe 73] [Evidenca 8 Plan Strategjik] [Evidenca 36.2 Vendim mbi ngritjen e NJSBC].</p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se Universiteti Luarasi ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si një strukturë e përhershme me Vendimin e Senatit Akademik të KU Luarasi e cila është funksionale. Njësia funksionale e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në Universitetin Luarasi zbaton strategjinë e miratuar të institucionit që ka në fokus kryesor përmirësimin e</p>

<p>të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>vazhdueshëm të cilësisë, duke përfshirë në këtë process ekspertë të jashtëm, si dhe përfaqësues të studentëve. Në të njëjtën kohë NJSBC ka hartuar dhe miratuar dhe strategjinë e kësaj zyre për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>[Evidenca 8 Plani Strategjik] [Evidenca 36.2 Vendim mbi ngritjen e NJSBC] [Evidenca 36.1 Strategjia e NJBSC]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se Njësia funksionale e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në Universitetin Luarasi ka hartuar dhe manualin e e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, bazuar në përcaktimet ligjore në fuqi për kodin e cilësisë i cili përmban dhe përshkruan të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me mënyrën e vetëvlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe aspekte të menaxhimit të cilësisë në kuadër të Fakulteteve dhe të Universitar Luarasi. NJSBC në funksion të detyrës për garantimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë bazuar në aktet rregullatore të UL, ka përdorur instrumentat e duhura në zbatim të strategjisë dhe manualit të miratuar të NJBSC kryesisht nëpërmjet procedurave të verifikimit, dokumentimit, anketimit dhe takimeve të zhvilluara me palët e interesuara. Universiteti Luarasi në 5 vitet e fundit ka kaluar të 2 format e procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, në mënyrë specifike në vitin 2016-2017 është realizuar Akreditimi Institucional nga ASCAL i cili ka përfunduar më datë 15.12.2017, i vlefshëm deri më 14.12.2023 (6 vite akademike).</p> <p>Institucioni ka bërë riorganizimin dhe kalimin nga Kolegj Universitar në Universitet dhe në këtë kuadër i është nënshtruar një procesi riakreditimi të pjesshëm. Me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 52, datë 27. 11. 2020 ka rimarrë akreditim pozitiv si Universitet me afat deri në 14.12.2023.</p> <p>[Evidenca 36 Manuali i NJBSC] [Evidenca 36 Manuali i NJBSC] [Evidenca 36.1 Strategjia e NJBSC] [Evidenca 36.3 Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar të cilësisë në metodat e mesimdhënis] [Evidenca 36.4 Si zbatohen në praktike syllabuset e lendeve] [Evidenca 36.5 Pyetësi i studenteve] [Evidenca 48 Certifikata e Akreditimit].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se Universiteti Luarasi ka hartuar një politikë të qartë për të ndjekur në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë procedura periodike që garantojnë dhe përmirësojnë cilësinë e programeve të studimeve, në këtë rast Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”. NJSBC ka përdorur instrumentat e duhura në zbatim të strategjisë dhe manualit të miratuar të NJBSC, sipas një plani kalendarik, kryesisht nëpërmjet procedurave të verifikimit, dokumentimit, anketimit dhe takimeve të zhvilluara me palët e interesuara., NJSBC organizon 2 herë në vit, në mënyrë anonime, 2 javë para përfundimit të aktivitetit mësimor semestral, pyetësin studentor për cilësinë e mësimdhënis në çdo program studimi, përfshirë edhe programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”.</p> <p>[Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi, neni 14 dhe 73] [Evidenca 8 Plani Strategjik 2016-2020] [Evidenca 36.3 Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar të cilësisë në metodat e mësimdhënis], [Evidenca 36.4 Si zbatohen në praktikë syllabuset e lëndëve],</p>

	[Evidenca 36.5 Pyetësi i studentëve] [Evidenca 27 Format i pyetesorit online] [Evidenca 27.1 Analiza e pyetesorit te studenteve]			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se Universiteti Luarasi ka ngritur Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si një njësi të posaçme me funksion të përhershëm me Vendimin e Senatit Akademik të KU Luarasi e cila është funksionale dhe është përgjegjëse për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen e programeve të ciklit të dytë. Kjo njësi përdor mekanizma e procese të formalizuara të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimeve të ciklit të dytë, përfshirë dhe Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, në zbatim të strategjisë dhe manualit të miratuar të NJSBC, sipas një plani kalendarik, kryesisht nëpërmjet procedurave të verifikimit, dokumentimit, anketimit dhe takimeve të zhvilluara me palët e interesuara.</p> <p>NJSBC organizon 2 herë në vit, në mënyrë anonime, 2 javë para përfundimit të aktivitetit mësimor semestral, pyetorin studentor për cilësinë e mësimdhënies në çdo program studimi, përfshirë edhe programi i studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”. NJSBC përgatit dhe vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuar, raportin e vlerësimeve periodike në procesin e shqyrtimit, miratimit dhe mbikëqyrjes së programeve të studimit. Në fund të vitit departamenti përgjegjës për programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” ka realizuar procesin e monitorimit dhe vlerësimit të ecurisë së këtij programi. Rezultatet e vlerësimit dhe sipas rasteve të identifikuar për përmirësim përkthehen në rekomandime për tu zbatuar dhe monitoruar më tej për përmirësimin dhe mbarëvajtjen e ecurisë së këtij programi.</p> <p>[Evidenca 8 Plani Strategji] [Evidenca 36.2 Vendim mbi ngritjen e NJSBC], [Evidenca 36.1 Strategjia e NJSBC] [Evidenca 36 Manuali i NJSBC]. [Evidenca 36.3 Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar të cilësive në metodat e mesimdhënies] [Evidenca 36.4 Si zbatohen në praktike syllabuset e lendeve] [Evidenca 36.5 Pyetësi i studentëve]. [Evidenca 27 Format i pyetesorit online] [Evidenca 27.1 Analiza e pyetesorit te studenteve] [Evidenca 19 Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit] [Evidenca Analiza e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies në shkollat e larta mbi bazën e metodave statistikore]</p>
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi,	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se Universiteti

instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	<p>Luarasi ka përdorur metodologji vlerësimi dhe instrumente të vlerësimit të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit, përfshirë dhe programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”. NJBSC ka organizuar aktivitete për procesin e monitorimit dhe vlerësimit të ecurisë dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor me mbështetjen e grupeve ad-hoc të ngritura pranë departamenteve. Rezultatet e procesit të monitorimit dhe vlerësimit të programeve të studimit raportohen nga NJBSC tek drejtuesit e departamenteve, fakulteteve dhe rektoratit të Universitetit Luarasi dhe jepen dhe rekomandimet përkatëse për tu zbatuar, zbatimi i të cilëve ndiqet dhe monitorohet nga strukturat drejtuese dhe vetë NJBSC.</p> <p>[Evidenca 36.5 Pyetësi i studentëve], [Evidenca 27 Format i pyetësorit online], [Evidenca 27.1 Analiza e pyetësorit të studentëve] [Evidenca 19 Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit].</p>			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se Universiteti Luarasi ka dokumentuar rezultatet e vlerësimeve, të cilat i ka raportuar tek autoritetet përgjegjëse dhe vendimmarrëse të programit të studimit. Raporti i rezultateve të nxjerra nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit të programeve të studimit raportohen nga NJBSC tek titullari i lëndës, drejtuesi i departamentit, dekani, së bashku me rekomandimet përkatëse, zbatimi i të cilëve ndiqet dhe monitorohet nga strukturat drejtuese dhe vetë NJBSC.</p> <p>[Evidenca 36.3 Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar të cilësisë në metodat e mësimdhënies] [Evidenca 36.4 Si zbatohen në praktikë syllabuset e lëndëve].</p>			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se Universiteti Luarasi për aktivitetet e monitorimit dhe të vlerësimit të ecurisë dhe mbarëvajtjes së programeve të studimit ka përgatitur raporte të cilat përmbajnë rezultatet e vlerësimit, masat e marra për adresimin e mangësive të identifikuar dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e tyre.</p> <p>[Evidenca 36.3 Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar të cilësisë në metodat e mësimdhënies] [Evidenca 36.4 Si zbatohen në praktikë syllabuset e lëndëve] [Evidenca 19 Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se Universiteti Luarasi realizon vlerësimin e brendshëm periodik të programit të studimit, Msc

<p>këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, nga NJBSC në nivel institucional, me mbështetjen e grupit ad-hoc të departamentit që mbulon programin e studimit, të cilat janë pjesë e procesit të vetëvlerësimeve të kryera në kuadër të akreditimeve apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.. Universiteti Luarasi gjatë vlerësimit ka përdorur metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta, si dhe mjete specifike, në përputhje me specifikat e fushës së programit të studimit. Një instrument shumë efektiv i përdorur në UL është përfshirja e studentëve në proceset e vlerësimit të programit të studimit, Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”, ku një përfaqësues i Këshillit të Studentëve është pjesë e NJBSC.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>[Evidenca 36.3 Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar të cilësisë në metodat e mësimdhënies] [Evidenca 36.4 Si zbatohen në praktikë syllabuset e lëndëve] [Evidenca 36.5 Vlerësimi i Cilësisë Pyetësori i Studentëve] [Evidenca 27 Format i pyetësorit online] [Evidenca 27.1 Analiza e pyetësorit te studenteve]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se Universiteti Luarasi, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” nëpërmjet strukturës përkatëse NJBSC ka përdorur metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për realizimin e vlerësimit si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vrojtme në orët mësimore në auditor; 2. Vrojtme gjatë kryerjes së praktikës; 3. Pyetësorët e studentëve për programin e studimit, mësimdhënia; 4. Rezultatet e studentëve nga vlerësimi i detyrave apo projekteve individuale apo në grup; 5. Rezultatet e studentëve në testet ndërmjetëse dhe përfundimtare të lëndëve të programit të studimit dhe në praktikat profesionale të studentëve; 6. Rezultatet e studentëve në provime të lëndëve të programit të studimit të vlerësuara me nota dhe pikë; 7. Rezultatet e studentëve në provimin përfundimtar të formimit të programit të studimit. <p>[Evidenca 36.3 Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar të cilësisë në metodat e mësimdhënies], [Evidenca 36.5 Vlerësimi i Cilësisë Pyetësori i Studentëve], [Evidenca 22 Institucionet ku janë kryer praktikat mësimore] [Evidenca 19 Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit] [Evidenca 34 Format raporti vlerësimi Pedagogu] [Evidenca 39 dhe 49 Format Mbledhje Departamenti].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se Universiteti Luarasi, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit ka përdorur metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi të tilla si</p>

<p>vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program</p>	<p>sondazhet për vlerësimin e mësimdhënies, të lëndëve/moduleve, si dhe të nxenit në programin e studimit. Raportet e rezultateve të vlerësimit nga sondazhet të përgatitura nga NJBSC i raportohen drejtuesit të departamentit, dekanit të fakultetit dhe rektoratit të institucionit, si dhe në mënyrë individuale i raportohen dhe personelit akademik pjesë e procesit të vlerësimit. Pjesë e procesit të vlerësimit kanë qenë vetëm personeli akademik dhe studentët e programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” dhe jo aktorët e tjerë të rekomanduar.</p> <p>[Evidenca 36.5 Vlerësimi i Cilësisë Pyetësori i Studentëve] [Evidenca 27 Pyetësori online i studentëve] [Evidenca 27.1 Analiza e pyetësorit të studentëve], [Evidenca 34 Format raporti vlerësimi Pedagogu] dhe [Evidenca 34.1 Format raporti me komente vlerësimi Pedagogu].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se Universiteti Luarasi, ka hartuar dhe garanton që në zbatimin e politikave dhe procedurave të brendshme të cilësisë të përfshihen aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”.</p> <p>Pjesë e NJBSC janë personeli i brendshëm akademik me eksperiencë, nga të 3 fakultetet e UL, ekspertë të jashtëm dhe përfaqësues të këshillit studentor.</p> <p>[Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi] [Evidenca 36.2 Vendim mbi ngritjen e NJSBC] [Evidenca 36 Manuali i NJBSC] [Evidenca 36.1 Strategjia e NJBSC].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se Universiteti Luarasi, ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për NJBSC, njësitë, studentët dhe palët e tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” duke garantuar përgjegjëshmëri në ushtrimin e detyrave.</p> <p>Në nivel institucioni përgjegjës të këtij procesi të rëndësishëm janë senati akademik, rektori, NJBSC, grupet e vlerësimit të brendshëm, dekani si dhe GVB të çdo fakulteti dhe studentët. Detyrat e tyre janë të mirëpërcaktuara në planin e aktiviteteve të strategjisë së NJBSC me objektiv madhor sigurimin e cilësisë të procesit mësimor në programin e studimit, Msc në “Teknologji Informacioni dhe</p>

kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	<p>Inovacioni” si dhe kërkohet pjesëmarrja aktive në propozimin, përcaktimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të modeleve vlerësuese sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p> <p>[Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi, pika 14 dhe 73], [Evidenca 36.2 Vendim mbi ngritjen e NJSBC], [Dok DVV Evidenca 36 Manuali i NJSB, pika 1] [Evidenca 36.1 Strategjia e NJSBC].</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se Universiteti Luarasi ka përfshirë dhe aktivizuar personel akademik të brendshëm dhe të jashtëm me eksperiencë si pjesë e NJSBC dhe e GVB të fakulteteve, si dhe përfaqësues të këshillit studentor të përzgjedhur në një proces të bazuar në vlerat më të mira dhe tërësisht transparent. Këta aktorë të brendshëm janë pjesëtar aktivë të procesit të vlerësimit të brendshëm në nivel institucioni dhe programi studimi. Ndërkohë përfshirja e ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit është vetëm në nivel institucioni dhe jo në nivel programi studimi.</p> <p>[Evidenca 5 Statuti Universiteti Luarasi, Kreu VIII], [Evidenca 15.1 Manuali i NJSB, pika 2] [Evidenca 15.2 Strategjia e NJSBC].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se Universiteti Luarasi, ka hartuar dhe zbaton politika dhe strategji transparente për organizimin dhe aktivitetet në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë, përfshirë edhe programin e studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” dhe ka bërë publike një pjesë të tyre për studentët dhe të gjithë të interesuarit, në faqen zyrtare të institucionit (Statuti i UL dhe manuali i NJSBC).</p> <p>GVJ konstaton se nga UL nuk janë bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit aktivitetet në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit.</p> <p><u>GVJ rekomandon që UL të bëjë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit aktivitetet në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit.</u></p>

	[Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi, Kreu VIII] [Evidenca 36 Manuali i NJBSC, pika 2] [Evidenca 36.1 Strategjia e NJBSC] [https://luarasi-univ.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/]
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se NJBSC, pas përfundimit të procesit të vlerësimit ka përgatitur rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit, përfshirë dhe Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”. Këto të dhëna personale dhe një pjesë sensitive janë ndarë përgjithsisht grupet me lidhje të drejtëpërdrejtë dhe përgjegjëse dhe në raste të veçanta kur të dhënat janë konsideruar se kanë një sensibilitet të lartë janë trajtuar nga strukturat drejtuese në takime individuale. GVJ konstaton se nuk janë bërë publike të dhënat e rezultateve të vlerësimit të programit të studimit duke respektuar lirinë dhe etikën akademike dhe duke iu përmbajtur legjislacionit për të dhënat personale.</p> <p>[Evidenca 9 Statuti Universiteti Luarasi, Kreu VIII], [Evidenca 36 Manuali i NJBSC, pika 2], [Evidenca 36.1 Strategjia e NJBSC]</p>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se Universiteti Luarasi, në raportet e përgatitura pas nxjerrjes së rezultateve të vlerësimit, ka evidentuar një plan masash që duhet të ndërmerren nga grupet dhe aktorët e përfshirë dhe interesuar për të arritur objektivin e përmirësimit të mangësive të identifikuar. Rezultatet e marra nga procesi i vlerësimit periodik janë përdorur jo vetëm për vlerësimin e procesit dhe identifikimin e problematikave, por edhe me objektiv marrjen e masave për përmirësimin e garantimin e cilësisë së brendshme të programeve të studimit.</p> <p>Disa nga masat e marra në drejtim të përmirësimit të cilësisë janë: trajnimet e vazhdueshme mbi metodat e sukseshme didaktike në mësimdhënie dhe kërkim shkencor; mbështetja e stafit akademik për pjesëmarrjen dhe përfshirjen në aktivitete dhe projekte zhvilluese edhe jashtë institucionit, në Shqipëri dhe jashtë.</p> <p>[Evidenca 36.3 Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar të cilësisë në metodat e mësimdhënies] [Evidenca 36.4 Si zbatohen në praktikë syllabuset e lëndëve] [Moduli i trajnimit - How to write and to publish an academic paper] [Moduli i trajnimit - Mësimdhënia me në qendër studentin] [Evidenca 13 Raport për projektet Luarasi], [Evidenca 14 Marreveshjet Erasmus tabela] [Evidenca 21 Institucionet bashkepunuese me Luarasin].</p>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se Universiteti Luarasi, ka vlerësuar dhe siguron monitorim të vazhdueshëm të procesit të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit të studimit, Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”. Ky proces vlerësimi dhe monitorimi ka objektiv madhor sigurimin e efektivitetit dhe impaktit të masave të marra për përmirësimin e mangësive dhe problematikave të identifikuar gjatë procesit të vlerësimeve periodike dhe siguron përmirësimin e cilësisë dhe të programit të studimit Msc në “Teknologji Informacioni dhe Inovacioni”.</p>

	[Evidenca 36.3 Raport mbi vëzhgimin e pa paralajmëruar të cilësisë në metodat e mësimdhënies] [Evidenca 36.4 Si zbatohen në praktikë syllabuset e lëndëve], [Evidenca 36.1 Strategjia e NJBSC], [Evidenca 36.5 Vlerësimi i Cilësisë Pyetësi i Studentëve] [Evidenca 27 Pyetësi online i studentëve].			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universitetin Luarasi, GVJ konstaton se Universiteti Luarasi, ka përfshirë stafin akademik dhe studentët në proceset e informimit, ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • pjesëmarrjes së tyre në NJBSC; • pjesëmarrjes në GVB ad-hoc të programeve të studimit në proces akreditimi; • në javën e orientimit në fillim të vitit akademik • dhe në mënyrë të tërthortë dhe me procesin e pyetësorëve të studentëve. <p>Por nuk ka organizuar veprimtari periodike trajnuese dhe informuese për këtë qëllim.</p> <p><i>GVJ rekomandon që IAL duhet të organizojë veprimtari periodike trajnuese dhe informuese me personelin dhe studentët për t'i informuar për nevojën e ndërgjegjësimin të tyre për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në proceset e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm dhe afatgjatë të cilësisë në programet e studimit, përfshi programin e studimit Msc në "Teknologji Informacioni dhe Inovacioni".</i></p> <p>[Evidenca 5 Statuti Universiteti Luarasi, Kreu VIII], [Evidenca 15.1 Manuali i NJBSC, pika 2], [Evidenca 15.2 Strategjia e NJBSC], [Evidenca 15.5 Vlerësimi i Cilësisë Pyetësi i Studentëve], [Evidenca 36 Pyetësi i studentëve] dhe [Evidenca 15 Vendim mbi ngritjen e NJSBC].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në
“Teknologji Informacioni dhe Inovacioni” të Universitetit “Luarasi”**

Pikat e forta dhe afirmime

1. Mjediset e përshtatshme dhe infrastruktura didaktike moderne në dispozicion të programit të studimit ofron hapësirat dhe kushtet e nevojshme bashkëkohore për procesin mësimor;
2. Programi i studimit është inovativ dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës;
3. Universiteti ka marrë akreditimi intitucional maksimal (6 vjet);
4. Institucioni ka zhvilluar mekanizma specifike për mbështetjen dhe kualifikimin profesional të personelit akademik;
5. Mbulimi i lëndëve të programit të studimit është në përputhje me fushën e ekspertizës së personelit akademik;
6. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi të reja në drejtim të bashkëpunimit akademik dhe profesional brenda dhe jashtë vendit;
7. Syllabuset janë në përputhje me standardet e kërkuara dhe të harmonizuara në funksion të njohurive me të cilat programi synon të formojë studentët;
8. Institucioni ka krijuar mekanizmat e nevojshëm institucionalë për të garantuar cilësinë.

Pika të dobëta

1. Mungesa e orëve laboratorike të përcaktuara në planin mësimor të këtij programi studimi, si formë e veçantë mësimdhënie.
2. Numri i kufizuar i teksteve fizike për literaturën bazë dhe të rekomanduar në bibliotekë për programin e studimit dhe mungesa e një një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit; Literatura e detyrueshme e programit të studimit, në disa lëndë është jo e 5 viteve të fundit.
3. Mungesa e një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm funksional për sekretarinë mësimore;

Rekomandime

1. Detajimi i planit mësimor me të gjithë format e mësimdhënies që përshkruhen nëpër syllabuset e lëndëve (vecanërisht orët laboratorike).
2. Institucioni të angazhohet për gjetjen e burimeve të tjera për financimin e programit të studimit, përveç tarifave studentore;
3. Të përditësohet literatura e detyrueshme për të gjitha lëndët e programit të studimit dhe të vazhdojë pasurimi sipas një plani të detajuar të teksteve në gjuhën shqipe dhe angleze të bibliotekës, në mbështetje të programit të studimit;

4. Marrja e masave të nevojshme për zhvillimin dhe vënien në funksion të sistemit të menaxhimit informatik të brendshëm për sekretarinë mësimore;
5. Institucioni/NJBSC duhet të bëjë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit aktivitetet, në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit. Gjithashtu ato në vazhdimësi duhet të organizojnë veprimtari periodike trajnuese / informuese me personelin dhe studentët për rritjen e ndergjegjësisë së tyre mbi rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në proceset e sigurimit të cilësisë.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master of Science in "Technology of Information and Innovation" of the "Luarasi" University

Strong points and affirmations

1. Appropriate facilities and modern didactic infrastructure available to the study program provide the necessary contemporary space and conditions for the learning process;
2. The study program is innovative and in line with the needs of the labor market;
3. The university has received maximum institutional accreditation (6 years);
4. The institution has developed specific mechanisms for the professional support and qualification of academic staff;
5. Coverage of study program subjects is in accordance with the field of expertise of academic staff;
6. The institution has signed new cooperation agreements in terms of academic and professional cooperation at home and abroad;
7. The syllabuses are in accordance with the required and harmonized standards in function of the knowledge with which the program aims to form students;
8. The institution has established the necessary institutional mechanisms to guarantee quality.

Weak points

1. Lack of defined laboratory hours in the curriculum of this study program, as a specific form of education;
2. A limited number of physical textbooks for basic and recommended literature in the library for the study program and lack of a detailed plan for adding library items in support of the study program. The mandatory literature of the study program, in some subjects is not of the last 5 years;
3. Lack of a functioning internal information management system for the teaching secretariat;

Recommendations

1. Detailed education plan including all teaching methods described in the course syllabus (especially laboratory classes);



2. The institution should commit to finding other resources to finance the study program, in addition to study tariffs;
3. Update the mandatory literature for all subjects of the study program and pursue the enrichment continuously according to a detailed textbook plan in Albanian and English language of the library, in support of the study program.
4. Taking the necessary measures for the development and operation of the internal information management system for the teaching secretariat.
5. The institution should make public for students and other interested parties the activities carried out in framework of IQ system for the study program. In the same time, the institution continuously should organize periodic training and informing activities with staff and students to raise the awareness on the importance of their active participation in the quality assurance processes.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Not përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X